REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA SHKODËR**

Nr 3976 prot. Shkodër, me 19.02.2026

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin: "Për miratimin e Udhëzuesit të Aplikimit "Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative", 2026 – 2028.

*Duke ju uruar punë të mbarë.*

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet Beci**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA SHKODËR**

Nr 3876/1 prot. Shkodër, me 19.02.2026

# RELACION

## "PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË APLIKIMIT "PËR ZBATIMIN E SKEMËS SË GRANTEVE PËR BIZNESE INOVATIVE", VITI 2026 – 2028.

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkia Shkodër në kuadër të zhvillimit ekonomik lokal, synon forcimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe koordinimin e vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror. Qëllimi ynë është të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të bizneseve një vlerë të shtuar në treg.

Një fokus i veçantë i dedikohet mbështetjes së bizneseve, si faktor kyç për rritjen ekonomike dhe punësimin, duke synuar promovimin e një modeli të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe inovativ dhe duke rritur vlerën e shtuar të proceseve, produkteve dhe shërbimeve të biznesit në tregun lokal dhe rajonal. Nga ana tjetër ky grant i dedikohet edhe individëve që kanë një ide biznesi inovativ, të cilën nuk kanë patur mundësi ta realizojnë më parë.

Qasja inovative e zhvillimit ekonomik bazohet në promovimin e koncepteve të reja të biznesit, përdorimin e teknologjive të reja dhe zbatimin e modeleve bashkëkohore të të bërit biznes. Inovacioni, në këtë kontekst, nuk kufizohet vetëm në krijimin e produkteve apo shërbimeve të reja, por përfshin gjithashtu përmirësimin e proceseve të punës, futjen e teknologjive digjitale, zhvillimin e metodave të reja të marketingut dhe modernizimin e strukturave organizative të bizneseve.

Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër ka parashikuar krijimin e skemës financiare, si instrument mbështetëse për sipërmarrësit aspirantë dhe bizneset ekzistuese, e cila mbështet zhvillimin e iniciativave ekonomike lokale, duke nxitur një qasje inovative në zhvillimin e biznesit. Kjo skemë granti ka për qëllim të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e bizneseve lokale dhe në të njëjtën kohë promovimin e ideve, produkteve dhe shërbimeve inovative.

Kjo në zbatim të funksioneve dhe kompetencave të veta, të përcaktuara në nenin 28 pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar; VKB nr. 84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit

2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër" P.AC141.Q1.O2.A3 Skemë granti për biznese inovative; Kërkesës nr. 1024 prot, datë 15.01.2026 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: 'Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin ''Skemë granti për biznese inovative'', nëpërmjet mbështetjes financiare me grante; Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.453/2 prot, datë 12.02.2026 me objekt: "Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore[1].

Sa më sipër merr iniciativën e hartimit të këtij udhëzuesi për zbatimin e dhënies së Granteve për ide dhe biznese inovative.

Fondi total i Skemës së Granteve për vitin 2026 është 5,000,000 lekë[2] nga të cilat 2.500.000 lekë janë të parashikuara në programin buxhetor Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural, aktiviteti *P.AC141.Q1.O2.A3. Skemë granti për biznese inovative ndërsa* 2.500.000 lekë do të përballohen përmes rialokimit të fondeve të trashëguara të vitit 2025, në të njëtin program, duke u financuar plotësisht nga Bashkia Shkodër.

Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në **500 000 lekë.**

**Granti do të ofrojë mbështetje për shtetasit shqiptarë mbi 18 vjeç, që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes ekzistues, janë banues në Bashkinë Shkodër dhe kanë dëshirë të zhvillojnë biznese inovative.** Ky grant është i disponueshëm për projekte me afat nga **6 deri në 9 muaj**, dhe shuma do të shpërndahet sipas planit financiar të aplikimeve fituese.

- Skema e grantit mbulon 80% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur, ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vetë aplikuesi në masën 20% të vlerës së projektit. Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare.
- Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 80% të fondeve, duhet të parashihen për aktivitetet e projektit.
- Granti nuk mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje, brenda 2 viteve. Pra nëse një biznes zgjidhet fitues dhe financohet, ai/ajo nuk mund të aplikojnë në thirrjen që do të shpallet në vitin pasardhës nga Bashkia Shkodër.

Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Shkodër dhe fondet e trashëguara të vitit 2025. Bashkia ka të drejtë të mos ndajë të

*1 Plani i Ndihmës Shtetërore do të zbatohet për vitet 2026 – 2028 sipas "Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.453/2 prot, datë 12.02.2026.*

*2 Shuma prej 5,000,000 lekë është planifikuar për vitin buxhetor 2026, ndërsa për dy vitet pasuese vlera do të rishikohet në përputhje me buxhetin vjetor të miratuar dhe programin buxhetor afatmesëm.*

Bashkëlidhur këtij relacioni po ju dërgojmë Udhëzuesin e aplikimit "Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative".

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

**KRYETAR**

**Benet Beci**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA SHKODËR

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

Belkiza Hema

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Mardusha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA SHKODËR**

Nr.3976/2 Prot | Shkodër, më 19.02.2026

**PROJEKT-VENDIMI**

**Nr.______, datë____.____.2026**

**PËR**
**"MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË APLIKIMIT PËR ZBATIMIN E SKEMËS SË GRANTEVE BIZNESE INOVATIVE", VITI 2026 -2028.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ___.___.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 28 pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", si dhe fish projekti P.AC141.Q1.O2.A3. Skemë granti për biznese inovative "; Kërkesës nr. 1024 prot, datë 15.01.2026 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: 'Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin ''Skemë granti për biznese inovative", nëpërmjet mbështetjes financiare me grante; "Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 453/2 prot, datë 12.02.2026 me objekt: "Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore.; relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik nr.______, datë ___/___/2026;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Udhëzuesin e Aplikimit "Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative", sipas materialit bashkëngjitur.

2. Fondi total i Skemës së Granteve për vitin 2026 është 5,000,000 lekë nga të cilat 2,500,000 lekë janë të parashikuara në programin buxhetor Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural, aktiviteti *P.AC141.Q1.O2.A3. Skemë granti për biznese inovative, ndërsa* 2,500,000 lekë do të përballohen përmes rialokimit të fondeve të trashëguara të vitit 2025, në të njëjtin program duke u financuar plotësisht nga Bashkia Shkodër.

3. Plani i Ndihmës Shtetërore do të zbatohet për vitet 2026 – 2028 sipas "Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 453/2 prot, datë 12.02.2026. Vlera totale e vënë në dispozicion për çdo vit është objekt rishikimi në përputhje me parashikimet buxhetore vjetore.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

Zv. Kryetar

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Elvin Ibrahimi

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve Mbështetëse.

Drejtoria e Financës

Drejtoria Juridike

P/ Marjola Fudhoxhia

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Marduska

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**

## KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues MEI Nr.Prot. 453/2, Data 12.2.2026

Shkurtimi i lëndës Komunikim sensimi

Për trajtim nga:

- ☐ N/Kryetar
- ☐ N/Kryetar
- ☐ N/Kryetar
- ☐ Kabineti Z.________
- ☐ **Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit**
  1. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
  2. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
  3. Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme
  4. Drejtoria e Aseteve dhe Kadastrës Urbane
- ☒ **Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik**
  1. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit
  2. Drejtoria e Turizmit
  3. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP
- ☐ **Drejtoria e Arsimit**
- ☐ **Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit**
  1. Drejtoria e Sportit
  2. Drejtoria e Kulturës
  3. Teatri "Migjeni"
- ☐ **Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**
  1. Drejtoria Juridike
  2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore
  3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
  4. Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit ZIN dhe TIK
- ☐ **Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve Sociale dhe Rinisë**
  1. Drejtoria e Shërbimeve Sociale
  2. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike
- ☐ **Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar**
  1. Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor
  2. Drejtoria e Financës
- ☐ **Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore**
- ☐ **Nj.A Ana e Malit**
- ☐ **Nj.A Bërdicë**
- ☐ **Nj.A Dajç**
- ☐ **Nj.A Guri i Zi**
- ☐ **Nj.A Postrribë**
- ☐ **Nj.A Pult**
- ☐ **Nj.A Rrethina**
- ☐ **Nj.A Shalë**
- ☐ **Nj.A Shosh**
- ☐ **Nj.A Velipojë**
- ☐ **Lagje**
- ☐ **Drejtoria e Komunikimit dhe Promovimit të Territorit**
- ☐ **Këshilli Bashkiak**
- ☐ **Njësia e Menaxhimit të projekteve strategjike**
- ☐ **Policia Bashkiake**
- ☐ **Emergjencat Civile**
- ☐ **Njësia e Prokurimit**
- ☐ **Njësia e Auditit**

---

- ☐ **Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike**
- ☐ **Drejtoria e Përgjitshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike**
- ☐ **Drejtoria e MZSH**
- ☐ **Q.Trajtimit të Studentëve**
- ☐ **Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç**
- ☐ **Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç**
- ☐ **Qendra e Zhvillimit**
- ☐ **Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh.a.**
- ☐ **IMT**
- ☐ **Gjendja Civile**
- ☐ **Administrimi dhe Inspektoriati i Pyjeve**
- ☐ **Skodrinon sh.a**

**Afati:** Normal (7 ditë) | Prioritet (3 ditë) | Urgjent (brenda ditës) | Pa afat për dijeni | Tjetër ___ ditë

**Data 16.2.2026, Nr.Prot. 3724**

**Shënime të Kryetarit:**

**Nënshkrimi: Benet Beci**

---

---

**Marrë në dorëzim: 18.02.2026**

**Nënshkrimi**________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E NXITJES SË BIZNESIT DHE ÇËSHTJEVE TË TREGTISË**

Nr. 453/2 Prot.     Tiranë, më 12.02.2026

Lënda: Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore

**BASHKIA SHKODËR**
Rruga 13 Dhjetori, nr. 1, Shkodër, Shqipëri

Në zbatim të nenit 9, të Ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, bashkëlidhur, ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 129, datë 10.02.2026 "Autorizim i Ndihmës Shtetërore "Mbështetje për bizneset inovative për të rinjtë në bashkinë Shkodër".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**SUZANA HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT TIRANË

VEND... KËRKESA
NR 3724 ... 16 2 2026
DER...
ZGJIDHJA E TITULLARIT:

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE**

# VENDIM

**Nr.** 129 **, datë** 10/02/2026

## AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "MBËSHTETJE PËR BIZNESET INOVATIVE PËR TË RINJTË NË BASHKINË SHKODËR

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

- Znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 10/02 /2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore" i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit", mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Shkodër lidhur me skemën e grantit për bizneset inovative.

## I. Procedura

(1) Bashkia Shkodër me shkresën nr. 1026 prot., datë 15.01.2026, me lëndë "Njoftim për Ndihmën Shtetërore për projektin "Skemë granti për biznese inovativ", në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore e sipërpërmendur në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84, datë 18.12.20025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028, të Bashkisë Shkodër".

## II. Përshkrimi i masës

(2) *Objektivi*: Skema synon të nxisë zhvillimin ekonomik nëpërmjet mbështetjes të të rinjve mbi 18 vjeç banues në Bashkinë Shkodër që kanë një ide biznesi apo një biznes ekzistues dhe synojnë të avancojnë në produkte inovative.

(3) *Baza Ligjore e planit të ndihmës:* Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028, të Bashkisë Shkodër", Programi AC141: Mbështetja për Zhvillim Ekonomik

(4) *Kohëzgjatja:* Plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2026-2028.

(5) *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Shkodër.

(6) *Përfituesit:* Përfituesit e kësaj skeme janë të rinjtë mbi 18 vjeç, banorë në Bashkinë Shkodër, që kanë një ide biznesi apo një biznes ekzistues. Për të rinjtë që kanë një ide biznesi, në rastin kur aplikimi i individeve është shpallur fitues, do të kërkohet regjistrimi i tyre në Qëndrën Kombëtarë të Biznesit.

(7) *Shtrirja sektoriale dhe territoriale:* Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

(8) *Forma dhe vlera e ndihmës:* Plani i ndihmës shtetërore është 9.000.000 (nëntë milionë) lekë gjithsej për periudhën 2026-2028 në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë Shkodër. Çdo përfitues do të mbështetet deri në shumën 500.000 (pesëqindmijë) lekë.

## III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

(9) Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të paragrafi 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

(10) Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton se:

*"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, shtrëmbëron ose kërcënon të shtrëmbërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".*

(11) Gjithashtu neni 71 "*Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike*", i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[1] përcakton se:
*"Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."*

(12) Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë <u>të gjitha</u> kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) Burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik, c) përzgjedhja dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

---
[1] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare".

(13) Plani i ndihmës përfshin transferimin e burimeve shtetërore, sepse projektet do të financohen drejtpërdrejt nga buxheti i miratuar për Bashkinë Shkodër. Kjo ndërhyrje krijon një avatazh ekonomik për bizneset përfituese, duke u siguruar atyre fonde në formën e grantit që lehtësojnë koston e të bërit biznes të cilat nuk do t'i përfitonin në kushtet e regut të lirë. Plani është selektiv sepse nuk është e hapur për të gjithë operatorët, por kufizohet specifikisht të bizneset e vogla dhe të mesme që propozojnë projekte në fushën e inovacionit dhe që kualifikohen përmes një procesi konkurrues përzgjedhës. Zbatimi i planit do të ndikojë në tregti dhe konkurrencë, sepse duke mbështetur produkte dhe shërbime inovative, forcon pozicionin e këtyre ndërmarrjeve përballë konkurrentëve të tjerë dhe potencialisht ndikon në shkëmbimet tregtare brenda dhe jashtë vendit.

Në këto kushte Komisioni vlerëson se në bazë të nenit 4, të ligjit 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

## IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

(14) Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit 9374/2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, i cili parashikon:

*"Ndihma "De minimis" është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh."*

Mbështetur në Kreun II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.08.2016 "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*", vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

*1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:*
  a. *vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milion) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në Kreun 3 të këtij vendimi.*
  b. *ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në Kreun 4 të këtij vendimi.*

Në Kreun III "Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit", të VKM nr.605, datë 31.08.2016 përcaktohet se: "1 .Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente".

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar dhe VKM nr. 605/2016, ndihma "*De minimis*" lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a. *vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milion) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në Kreun 3 të këtij vendimi.*

b. *ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në Kreun 4 të këtij vendimi.*

Dhënësi i ndihmës do të akordojë dhënien e ndihmës shtetërore në formën e grantit për një ndërmarrje ndihmë shtetërore që nuk kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milion) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore "de minimis" është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore" të ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 22, dhe 31 të Ligjit Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

**VENDOSI :**

1. Të autorizojë planin e ndihmës shtetërore "Mbështetje për bizneset inovative për të rinjtë" të miratuar më Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 - 2028, të Bashkisë Shkoder".
2. Çdo përfitues i ndihmës duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës "*De-minimis*" dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Bashkisë Shkodër.
3. Bashkia Shkodër brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe impaktin ekonomik të skemës.
4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.
5. Ky vendim të botohet në fletoren zyrtare.

**KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE**

**KRYETAR**

**DELINA IBRAHIMAJ**

**ANËTARË**

**MIMOZA DHËMBI**

**BESNIK ÇINA**

**KEIDA QIRKO**

**AHMET MANÇELLARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

# Udhëzues i Aplikimit

'Për zbatimin e skemës së granteve'

**Skemë granti për biznese inovative**

Shkodër, Shkurt 2026

**PËRMBAJTJA:**


1. **Hyrje**
2. **Qëllimi dhe Objektivat**
3. **Përfitimet e një biznesi inovativ**
4. **Përfituesit e skemës**
5. **Buxheti**

**UDHËZUESI I APLIKIMIT**

1. **Çfarë është granti për bizneset inovative?**
2. **Mbështetja financiare**
3. **Aplikantët e pranueshëm**
4. **Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema**
5. **Mbulimi gjeografik**
6. **Strukturat e skemës së grantit dhe detyrat e tyre**
7. **Mënyra e procedimit të skemës së grantit**
8. **Zbatimi i skemës për vitet e ardhshme**
9. **Anekset**

# 1. Hyrje

Zbatimi i politikave vendore për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të bizneseve përbën një sfidë, prandaj është e rëndësishme të përqendrohemi në inkurajimin e iniciativave që nxisin dhe zhvillojnë bizneset e reja dhe ekzistuese. Një gjë e tillë është thelbësore për ndërtimin e një ekonomie të fortë, konkuruese dhe inovative.

Kur këto iniciativa ndërthurin konceptet e ekonomisë dhe inovacionit, ato krijojnë një model të ri zhvillimi ekonomik që është në gjendje të përballojë sfidat bashkëkohore të zhvillimit. Një qasje e tillë quhet inovacion në biznes dhe është një term që po përdoret gjërësisht. Inovacioni në biznes i referohet procesit të prezantimit të ideve, metodave, produkteve ose shërbimeve të reja që krijojnë vlerë për biznesin dhe klientët e saj. Ai përfshin të menduarit në mënyrë krijuese për të zgjidhur problemet, për të përmirësuar proceset dhe ruajtjen e konkurrueshmërisë në treg. Pavarësisht nëse është një produkt i ri, një strategji marketingu e ndryshuar, ose një proces më efikas, inovacioni është i rëndësishëm për të mbajtur një biznes konkurrues dhe të suksesshëm. Zbatimi i një procesi të tillë krijon përparësi të qëndrueshme për biznesin, pasi është në gjëndje t'i japë zgjidhje afatgjatë ndryshimit të tendencave të reja të tregut.

Qëllimi ynë është të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të bizneseve një vlerë të shtuar në treg. Ky proces inovativ përfshin të gjitha fazat e ciklit jetësor të një produkti, nga zhvillimi i tij fillestar, prodhimi, shpërndarja, përdorimi dhe deri te riciklimi ose asgjësimi i tij. Kjo qasje e re menaxhimi çon në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit dhe tërheqjen e investimeve të reja për biznesin, dhe njëkohësisht ndikon në uljen e kostove dhe zhvillimin e bizneseve të bazuara në ide inovative, krahasuar me alternativat ekzistuese.

Në kushtet e tregut modern, ku ndryshimet teknologjike dhe konkurrenca janë të vazhdueshme, inovacioni është bërë një domosdoshmëri dhe jo më një zgjedhje. Bizneset që synojnë të rriten, të mbeten të njohura dhe të vlerësuara në treg duhet të jenë të gatshme të përshtaten dhe të krijojnë vazhdimisht zgjidhje të reja. Përmes inovacionit, kompanitë arrijnë jo vetëm të përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre, por edhe të përgjigjen më mirë ndaj nevojave të klientëve, të krijojnë avantazh konkurrues dhe të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm në një mjedis gjithnjë e më dinamik.

Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër synon të forcojë bashkëpunimin me sektorin privat, në koordinim të ngushtë me institucionet e tjera përgjegjëse për të ofruar një qasje të qëndrueshme dhe efektive, e orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe e bazuar në një skemë granti për financimin e sipërmarrësve aspirantë që kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues dhe janë të regjistruar në Bashkinë Shkodër. Kjo, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një praktikë e mirë, të cilën parashikon ta zbatojë në vitet në vazhdim për disa sektorë të ekonomisë.

Skema e Grantit do të zbatohet përmes një procesi të bazuar në konkurencë, me qëllim që të sigurohet kthimi më i lartë i mundshëm i investimit. Ky proces konkurues do të bëjë të mundur përzgjedhjen e projekteve më të mira dhe më të qëndrueshme, duke garantuar përdorimin efikas të fondeve dhe maksimizimin e përfitimeve për bizneset dhe komunitetin.

## 2. Qëllimi dhe Objektiva

### 2.1 Çfarë është Ekonomia "inovative"?[1]

Ekonomia "inovative" është një element i ekonomisë i bazuar në prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e ideve, informacionit dhe njohurive. Një sistem i bazuar në treg që përdor kërkimin dhe zhvillimin për të krijuar produkte ose shërbime të reja. Inovacioni në ekonomi mund të marrë shumë forma, si teknologjitë e reja, modelet dhe proceset e biznesit ose strukturat organizative. Ekonomia e inovacionit është një sistem i ndërlidhur ku bizneset vazhdimisht mësojnë dhe zhvillojnë mënyra të reja për të përdorur teknologjinë për përfitime komerciale. Sipërmarrja është një komponent kyç i ekonomisë së inovacionit pasi inkurajon individët të ndërmarrin rreziqe duke investuar burimet e tyre në zhvillimin e ideve inovative.

### 2.2 Çfarë është biznesi "inovativ"?[2]

Një biznes "inovativ" përfshin riformësimin e proceseve, transformimin e përvojave të klientëve dhe krijimin e tregjeve krejtësisht të reja. Inovacioni u mundëson kompanive të përshtaten me ndryshimet e shpejta të teknologjisë, kërkesave të konsumatorëve dhe dinamikave të tregut. Në një mjedis gjithnjë e më konkurrues, bizneset që nuk arrijnë të përshtaten dhe të zhvillojnë ide të reja rrezikojnë të humbasin rëndësinë e tyre në treg, të mbeten pas konkurrentëve dhe, në afat të gjatë, të dalin nga tregu. Nga ana tjetër, kompanitë që përqafojnë zgjidhjen krijuese të problemeve, inkurajojnë mendimin ndryshe dhe investojnë në ide të reja, pozicionohen më mirë për të kapur mundësitë në zhvillim. Këto biznese jo vetëm që reagojnë ndaj ndryshimeve, por shpesh bëhen vetë nxitës të tyre. Përmes inovacionit, ato rrisin efikasitetin, përmirësojnë cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, si dhe ndërtojnë marrëdhënie më të forta dhe më të qëndrueshme me klientët.

## 3. Qëllimi dhe Objektivat

### 3.1 Qëllimi i Skemës së Grantit

***Qëllimi*** është të krijojë mundësi të reja ekonomike për sipërmarrësit aspirantë dhe bizneset ekzistuese, bazuar në një skemë granti, e cila mbështet zhvillimin e iniciativave ekonomike lokale, duke nxitur një qasje inovative në zhvillimin e biznesit. Kjo skemë granti ka për qëllim të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e bizneseve lokale dhe në të njëjtën kohë promovimin e ideve, produkteve dhe shërbimeve inovative.

### 3.2 Objektivat e Skemës së Granteve

- Të krijojë një model transparent dhe të bazuar në projekte konkrete për mbështetjen e bizneseve.

---

[1] European Commission. (2013). *Entrepreneurship 2020 Action Plan: Reigniting the entrepreneurial spirit in Europe*. Publications Office of the European Union. E disponueshme ne: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52013IP0512

[2] OECD. (2010). *The OECD innovation strategy: Getting a head start on tomorrow*. OECD Publishing. E disponueshme ne: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2010/05/the-oecd-innovation-strategy_g1ghcb7c/9789264083479-en.pdf.

- Të ndërgjegjësojë dhe nxisë individët dhe bizneset lokale shkodrane që të angazhohen në veprimtari ekonomike lokale.
- Të mbështesë krijimin dhe zgjerimin e bizneseve përmes zhvillimit dhe zbatimit të ideve të reja, teknologjive bashkëkohore dhe praktikave inovative që rrisin konkurrueshmërinë dhe vlerën në treg.
- Të përmirësojë aftësitë e nevojshme rreth planifikimit të biznesit dhe menaxhimit financiar, që të jenë të suksesshëm në krijimin dhe zgjerimin e bizneseve të tyre.

### 3.3 Përfitimet e Skemës së Granteve

Kjo Skemë financimi, që po zbatohet për herë të dytë në Bashkinë Shkodër, do të nxisë krijimin e bizneseve inovative, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e shoqërive prodhuese, dinamike dhe të qëndrueshme. Këto biznese mund të luajnë një rol kryesor në përparimin teknologjik dhe ekonomik, duke kontribuar në rritjen e konkurrencës, zhvillimin e ideve të reja dhe krijimin e vendeve të punës.

Nga ana tjetër skema do të përmirësojë më tej bashkëpunimin ndërmjet bashkisë dhe bizneseve lokale.

Përfitimet e bizneseve inovative përfshijnë hyrjen në tregje të reja dhe të pashfrytëzuara, rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit përmes përdorimit të teknologjive dhe proceseve të reja, kursimin e kostove dhe përmirësimin e performancës së stafit, përmes krijimit të një ambienti pune më efikas dhe të motivuar.

**Disa nga përfitimet e një biznesi inovativ:**[3]

***Diferencim konkurrues*** – Inovacioni mundëson të ofrohen produkte dhe shërbime unike që i vendosin bizneset në një pozitë të dalluar në treg. Studimet tregojnë se inovacioni i produktit mund të rrisë avantazhin konkurrues deri në 53.1%, ndërsa inovacioni i proceseve kontribuon me 47.2%, dhe inovacioni i fokusuar te njerëzit shton 44.5%.

***Zgjidhje të bazuara tek klienti*** – Duke zhvilluar vazhdimisht ofertat sipas nevojave të klientëve, mund të tërhiqen dhe të mbahen klientë të besuar. Rreth 65% e klientëve presin që kompanitë të përshtatin vazhdimisht produktet dhe shërbimet për të plotësuar nevojat dhe preferencat e tyre.

***Rritje dhe zgjerim*** – Inovacioni hap mundësi të reja për zgjerimin e biznesit, hyrjen në tregje të reja dhe rritjen e të ardhurave.

***Efikasitet operativ*** – Përdorimi i mjeteve smart dhe optimizimi i proceseve përmes inovacionit ndihmon ekipet të punojnë më shpejt dhe më efektivisht. Shumë biznese që përdorin mjete digjitale inovative raportojnë rritje produktiviteti deri në 20–30%, dhe efikasiteti mund të rritet edhe më shumë duke përdorur mbështetje virtuale për detyra rutinë.

***Angazhimi i talentit*** – Ofrimi i mundësive për punonjësit të eksplorojnë ide të reja rrit motivimin, kënaqësinë dhe mbajtjen afatgjatë të stafit.

[3] IMD Business School. (n.d.). *Innovation in business: Importance, benefits, and examples*. E disponueshme në https://www.imd.org/reflections/innovation-in-business-importance-benefits-examples/.

***Rezistencë e biznesit*** – Inovacioni i vazhdueshëm forcon aftësinë për t'u përshtatur gjatë krizave dhe për të "lulëzuar" në kushte të ndryshuara.

**3.5 Përfituesit e skemës së grantit:**

***Sipërmarrësit Aspirantë:*** Individë që kanë ide për të filluar një biznes të ri dhe kërkojnë mbështetje për të realizuar këto ide.

***Bizneset ekzistuese:*** Biznese ekzistuese me qarkullim vjetor ≤ 8,000,000 lekë/vit 4 që kërkojnë të zgjerohen, të modernizohen ose të implementojnë praktika të qëndrueshme dhe inovative.

[4] Ligji nr .9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar.

**UDHËZUESI I APLIKIMIT**

**"Krijimi i një skeme garancie për bizneset inovative, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante"**

Ky udhëzues përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në mënyrë profesionale dhe transparente skemën e grantit. Udhëzuesi bazohet në nenin 28 pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028, të Bashkisë Shkodër"; fish projekti P.AC141.Q1.O2.A3, ''Skemë granti për biznese inovative" të buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë Shkodër dhe programit buxhetor 2026 -2028"; Kërkesës nr. 1024 prot, datë 15.01.2026 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: 'Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin ''Skemë granti për biznese inovative", nëpërmjet mbështetjes financiare me grante; "Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.453/2 prot, datë 12.02.2026 me objekt: "Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Sa më sipër merr iniciativën e hartimit të këtij udhëzuesi për zbatimin e dhënies së Granteve për ide dhe biznese inovative.

## 1. Çfarë është Granti për "Bizneset Inovative"?

Granti për bizneset inovative është një aktivitet i Bashkisë Shkodër, i financuar nga burime publike (të parashikuara në buxhetin e vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028, të Bashkisë Shkodër, në Programin AC141 "Mbështetje për zhvillimin Ekonomik", i projektuar për të mbështetur financiarisht (Grant) bizneset e reja, të cilat bazohen në një model inovativ, ose biznese ekzistuese që synojnë të transformohen përmes zbatimit të ideve dhe praktikave inovative.

Kjo skemë granti është hartuar për t'i shërbyer individëve/sipërmarrësve aspirantë, por edhe bizneseve ekzistuese.

*Projekti synon të mbështesë financiarisht kategoritë si më poshtë:*

- Individë/sipërmarrës aspirantë që synojnë të prodhojnë produkte inovative, të ofrojnë shërbime të reja ose të zbatojnë procese bashkëkohore dhe kreative në biznesin e tyre;
- Biznese ekzistuese me një qasje inovative dhe të orientuar drejt zhvillimit;
- Biznese që shndërrojnë burime ose materiale të pashfrytëzuara në produkte, shërbime apo zgjidhje me vlerë të shtuar përmes inovacionit;
- Biznese që shfrytëzojnë potencialin lokal duke aplikuar modele të reja dhe ide inovative në komunitet;
- Biznese të tilla si agrobiznes (prodhim, përpunim, tregtim) që zbatojnë teknologji moderne, metoda inovative dhe modele të reja të zhvillimit dhe i tregtojnë produktet e tyre në nivel lokal;
- Biznese që përdorin teknologji të avancuara, materiale alternative ose zgjidhje moderne në proceset e prodhimit dhe zhvillimit të produkteve;
- Biznese me ide inovative në krahasim me bizneset e tjera, të cilat ofrojnë zgjidhje të reja dhe kreative për adresimin e sfidave ekonomike, sociale apo të tregut;

## 2. Mbështetja financiare

Fondi total i Skemës së Granteve është **5,000,000 lekë,** dhe financohet plotësisht nga Bashkia Shkodër.[5]

**Granti për aplikim**: Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në 500,000[6] lekë.

**Granti do të ofrojë mbështetje për shtetasit shqiptarë mbi 18 vjeç, që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes ekzistues, janë banues në Bashkinë Shkodër dhe kanë dëshirë të zhvillojnë biznese inovative.** Ky grant është i disponueshëm për projekte me afat nga **6 deri në 9 muaj**, dhe shuma do të shpërndahet sipas planit financiar të aplikimeve fituese.

- Skema e grantit mbulon 80% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur, ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vetë aplikuesi në masën 20% të vlerës së projektit. Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare[7].

- Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 80% të fondeve, duhet të parashihen për aktivitetet e projektit.

- Granti nuk mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje, brenda 2 viteve. Pra nëse një biznes zgjidhet fitues dhe financohet, ai/ajo nuk mund të aplikojnë në thirrjen që do të shpallet në vitin pasardhës nga Bashkia Shkodër.

- Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Shkodër.

- Bashkia ka të drejtën për të mos ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

- Aplikantët e përzgjedhur mund të planifikojnë financim tjetër shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, hua, grante, etj.) të disponueshme në Shqipëri nëpërmjet institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë të tjerë, ose me financat e tyre. Në të gjitha rastet e mësipërme, financimi shtesë duhet të deklarohet bashkë me burimin e financimit. Financimi shtesë duhet të përdoret së bashku me asistencën e grantit për fillimin e planit të biznesit, prandaj burimi i financimit duhet

*5 Plani i Ndihmës Shtetërore do të zbatohet për vitet 2026 – 2028 sipas "Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 453/2 prot, datë 12.02.2026. Shuma prej 5,000,000 lekë është planifikuar për vitin buxhetor 2026, ndërsa për dy vitet pasuese vlera do të rishikohet në përputhje me buxhetin vjetor të miratuar dhe programin buxhetor afatmesëm.*

*6 Ndarja e shpenzimeve personel/aktivitete mund të jetë objekt rishikimi.*

[7] *Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare, por mund të shprehet me kontribut në natyrë (in-kind), që mund të jenë paga, vlerë qeraje ambjenti (për bizneset ekzistuese), vlerë pajisjesh ekzistuese, etj.* ***Shembull:*** *Nëse aplikoni për shumën prej 500,000 lekësh, 20% e kësaj shume do të bashkëfinancohet nga aplikanti, duke e rritur vlerën totale të projektit në 625,000 lekë (500,000 lekë + 20% kontributi nga aplikanti). Nëse aplikoni për shumën prej 400,000 lekësh, 20% e kësaj shume do të bashkëfinancohet nga aplikanti, duke e rritur vlerën totale të projektit në 480,000 lekë (400,000 lekë + 20% kontributi nga aplikanti).*

të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit.

- Nëse instrumenti financiar do të përdoret për zgjerim të mëtejshëm të biznesit, kjo mbështetje shtesë e përfituar pritet që vetëm të raportohet në vizitat dhe raportet e monitorimit.
- Shpenzimet e parakryera nuk do të njihen si investim por vetëm shpenzimet pas nënshkrimit të kontratës së grantit janë të vlefshme.
- Përfituesit e fondeve nuk janë të autorizuar për kalimin e tyre tek palë të treta. Të gjithë detajet specifike mbi kohën dhe pagesat do të përcaktohen në marrëveshjen kontraktuale të grantit në përputhje me projektin dhe specifikat e tij.

**3. Likuidimi i shpenzimeve:**

Pagesa e grantit të miratuar bëhet me transfertë bankare. Bashkia e Shkodrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të buxhetit të përcaktuar në aplikim, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate nga fondi i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

Levrimi i shumës do të bëhet sipas buxhetit të përcaktuar në aplikim. Kusht për lëvrimin e një shume është realizimi i shpenzimeve dhe dorëzimi i dokumentacionit mbështetës narrativ dhe financiar, dhe verifikimit të tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik për shpenzime që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e biznesit, sipas pikës 6.1 për përiudhën kohore nga nënshkrimi i kësaj kontrate deri në përfundim të saj.

**4. Aplikantët e pranueshëm**

Aplikantët e pranueshëm të Skemës janë të gjithë individët, shtetas shqiptarë me moshë mbi 18 vjeç, banorë të Bashkisë Shkodër, të cilët kanë një ide për të krijuar një biznes inovativ, i cili do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

Çdo aplikant mund të marrë pjesë me vetëm një ide biznesi për çdo thirrje. Nëse shpallet fitues, ai nuk mund të aplikojë vitin pasardhës.

Aplikimet nga bizneset e reja do të pranohen nëse plotësohen kriteret e sipërpërmendura dhe nëse aplikuesi:

1. Është i regjistruar dhe është banor në Shkodër;
2. Është mbi moshën 18 vjeç;
3. Nuk është në likuidim, falimentim apo procedurë për mbyllje;
4. Ka paguar të gjitha detyrimet ndaj tatimeve si dhe taksat dhe tarifat vendore;
5. Është i gatshëm të regjistrojë biznesin e tij/saj në Shkodër para nënshkrimit të kontratës me Bashkinë Shkodër (në rastin e individëve).

**5. Aplikantë jo të pranueshëm**

Aplikantët që nuk përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur janë ata, të cilët kanë një konflikt interesi me palët e përfshira në skemë.

Gjithashtu, nuk pranohen ata aplikues që kanë përfituar grante nga Bashkia Shkodër dhe nuk kanë mbyllur me sukses kontratën përkatëse.

Aplikantët ideja e biznesit e të cilëve nuk përmban një qasje ose proces inovativ për

zhvillimin e biznesit.

## 6. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema

### 6.1 Shpenzimet e pranueshme nga skema

Shpenzimet e njohura që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- Blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, website si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme të cilat do të shërbejnë për të diversifikuar prodhimin me produkte të reja ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të këtyre produkteve;
- Shpenzime për asete të tjera të paprekshme (liçenca, markim dhe patentim produktesh);
- Pagat dhe sigurimet do të mbulohen vetëm për të punësuarit që lidhen drejpërdrejtë me procesin e prodhimit të produkteve/shërbimeve, deri në 2 muajt e parë nga fillimi i aktivitetit të biznesit, por pa tejkaluar më shumë se 20% të grantit.

### 6.2 Shpenzime që nuk mbulohen nga skema

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga paratë e grantit përfshijnë:

- shpenzimet e lindura/krijuara përpara nënshkrimit të kontratës së grantit;
- mirëmbajtje dhe riparime;
- vlera e qerasë së ambjentit;
- blerjen e pasurive të patundshme (tokë, godina, etj.);
- blerjen e mjeteve të transportit;
- çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar;
- zbavitje dhe dhurata.

## 7. Mbulimi gjeografik

Skema e dhënies së Granteve do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

## 8. Strukturat e skemës së Grantit dhe detyrat e tyre

Skema e grantit do të zbatohet nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik. Në këtë aktivitet do të përfshihen në disa hapa konkretë të zbatimit dhe struktura të tjera të Bashkisë Shkodër, sipas fushës së thirrjes, në çdo rast Drejtoritë përgjegjëse do të përcaktohen në Urdhërin e grupit të punës për organizimin dhe manxhimin e shpalljes së thirrjes.

Skema do të zbatohet nga strukturat e mëposhtme:

- Komisioni i Vlerësimit
- Koordinatori i Skemës/ Sekretari i Komisionit
- Ekspertët/mentorë për monitorim
- Grupi i monitorimit për zbatimin, certifikimin, pranimin e shpenzimeve.

## 9. Strukturat e menaxhimit të skemës

### 9.1 Komisioni për Vlerësimin

Komisioni i Vlerësimit të aplikimeve është organi i krijuar nga bashkia që bën vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në skemën e grantit. Puna e Komisionit të Vlerësimit do të jetë në përputhje me rregullat e skemës së grantit dhe kriteret e përcaktuara qartë për vlerësimin e aplikimeve.
***Ky Komision do të ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Shkodër.***

Takimet e Komisionit do të organizohen pranë ambienteve të Bashkisë Shkodër. Anëtarët e Komisionit do të vlerësojnë secilin aplikim për ide biznesi në mënyrë të pavarur, bazuar në kriteret e përcaktuara.

## 10. Srukturat operacionale dhe të mbështetjes

### 10.1 Koordinatori i Skemës së Grantit

Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik do të shërbejë si Koordinator i Skemës dhe është përgjegjës i menaxhimit operacional të saj, deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit. Koordinatori është përgjegjës për zbatimin në kohë të të gjitha aktiviteteve të skemës dhe ndjek kalendarin e miratuar, deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit. Gjithashtu, ai/ajo organizon takimet e Komisionit të Vlerësimit, siguron shpërndarjen e dokumenteve tek ata, si dhe mbledh firmat nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Koordinatori është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha dokumenteve deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit dhe ruajtjen e tyre në arkiv.

***Koordinatori i Skemës së Grantit do të caktohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Shkodër.***

## 11. Trajnuesit

Trajnuesit (një ose dy) në planifikimin e biznesit do të ofrojnë trajnim për aplikantët e përzgjedhur. Qëllimi i tyre do të jetë të mësojnë të sipërmarrësit aspirantë se si mundet të ndërtohet një Plan Biznesi i qëndrueshëm. Trajnuesit do të caktohen nga stafi i Bashkisë Shkodër ose nga organizata partnere/institucione/agjenci, të cilat dëshirojnë të ofrojnë asistencë në Skemë pse jo edhe mbështëtje financiare.

## 12. Mënyra e procedimit të skemës së grantit

"Skema e grantit" do të zbatohet në dy faza kryesore. Secila fazë përfshin disa hapa, të cilat sigurojnë menaxhim efikas dhe transparencë, si më poshtë:

**Faza I:**
- Shpallja e thirrjes dhe zhvillimi i një fushate informuese;
- Përzgjedhja e ideve të aplikantëve;

**Faza II:**
- Pergatitja dhe aplikimi i planeve të biznesit;
- Vlerësimi dhe përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit;
- Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve;
- Monitorimi dhe vlerësimi.

### 12.1 Shpallja e thirrjes dhe zhvillimi i një fushate informuese;

Thirrjet për shprehjen e interesit do të shpallen në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër. I gjithë procesi do të kalojë në dy faza:

- Faza I: Organizimi i thirrjes dhe dorëzimi i ideve të biznesit;
- Faza II: Dorëzimi i planeve të biznesit për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.

**Faza I: Organizimi i thirrjes dhe dorëzimi i ideve të biznesit;**

Një fushatë informuese do të organizohet gjatë kohëzgjatjes së thirrjes, me qellim njohjen e aplikuesve të mundshëm me kriteret e kësaj skeme, mënyrën e aplikimit, etj.

Një ***Njoftim Publik*** (Aneksi 1) do të hartohet nga Koordinatori i Skemës. Njoftimi duhet të përfshijë informacion për tërësinë e procesit të aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Ai duhet të përfshijë gjithashtu informacion për çdo takim informues që do të organizohet gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes. Njoftimi duhet të publikohet në faqet e internetit të Bashkisë Shkodër.

***Takimet informuese*** (Aneksi 2) duhet të organizohen nga Bashkia Shkodër për të transmetuar informacionin e nevojshëm tek të gjithë aplikantët në një mënyrë të standardizuar dhe të njëjtë. Synimi i këtyre takimeve do të jetë shpërndarja e informacionit te aplikantët e mundshëm të pranueshëm që në të kundërt do të kenë akses të kufizuar te kanalet formale të komunikimit.

Takimet informuese do të organizohen gjatë dy javëve të para të fushatës. Duke përdorur një qasje hap pas hapi, aplikantët informohen për kushtet e përgjithshme të skemës, procedurat e aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë.

Shpallja e skemës së grantit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe Faza e I-rë do të qendrojë e hapur minimumi 4 javë. Ajo do të përmbajë:

- Formularin e Aplikimit për ide biznesi për grantin; (Aneksi 3)

Si dhe të tjera dokumenta mbështetës si më poshtë vijon:

1. Kopja e kartës së identitetit të Aplikantit;
2. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), për bizneset ekzistuese;
3. Vertetim xhiro për 3 vitet e kaluara nga e-albania për bizneset ekzistuese;
4. Vërtetim për saktësim adrese.

### 12.2 Dorëzimi i aplikimit për ide biznesi (Aneksi 3)

Aplikimet për ide biznesi të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm duhet të dorëzohen pranë sportelit të Z1N, në Bashki në tre (3) kopje të printuara dhe një kopje elektronike (në CD ose USB) dorazi, në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar emri i

thirrjes publike ***Formular aplikimi për pjesëmarrjen në skemën e granteve për biznese inovative,*** emri i plotë dhe adresa e aplikantit.

Afati i dorëzimit të aplikimeve është **DITA, DATA**, deri në orën 16:00, gjatë ditëve të punës (e hënë deri në të premte), midis orës 08:00 dhe 14:00, në adresën: adresa e bashkisë:

**Zyra me Një Ndalesë (Z1N), Bashkia Shkodër**
**Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1**
**4001, Shkodër**

Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.

**Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.**

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:
- Një verifikim formal i adresës, kryhet në sportelin e Z1N, dokumentet të cila nuk kanë adresë, nuk do të pranohen;
- Çdo kandidati i caktohet një numër reference me datën dhe orën e dorëzimit.

### 12.3 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve

Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve do të kalojë në dy faza të cilat janë:

- Faza e 1: Vlerësimi i aplikimit të ideve të biznesit;
- Faza e 2: Vlerësimi i planit të biznesit ( *për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.)*

Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimit të ide bizneseve (Aneksi 3) dhe planit të biznesit (Aneksi 7) do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit. Takimi do të organizohet nga Koordinatori i skemës. Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 janë përfaqësues të Bashkisë Shkodër, një përfaqësues i Universitetit 'Luigj Gurakuqi' dhe një përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë Shkodër.

Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhja e kandidatëve do të përfundojë jo më vonë se 5 ditë punë pas afatit përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve *të ide bizneseve.* Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë të pranishëm në takim.

Koordinatori i Skemës shpërndan të gjithë zarfat e marrë me aplikime. Përpara fillimit të procesit të vlerësimit, të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të nënshkruajnë me shkrim ***deklaratën e paanshmërisë dhe konfidencialitetit***. Ky akt i detyron të ruajnë konfidencialitet të plotë të informacionit që përmbajnë aplikimet, si dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit të aplikimeve. Nënshkrimi i deklaratës garanton integritetin e të gjithë informacionit brenda procesit të vlerësimit deri sa rezultatet të publikohen dhe të vihen në dispozicion të publikut të gjerë. Kjo mbron interesin e aplikantëve si dhe të gjithë pjesëtarëve të tjerë në këtë proces.

Secili anëtar i Komisionit do të vlerësojë secilën ide biznes (Faza I) dhe plan biznesi (Faza II-

) individualisht si më poshtë:

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(1) Kushteve administrative:

- Aplikimi është i kompletuar sipas kerkesave të thirrjes.
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).

(1) Kushtet që kanë të bëjnë me Aplikuesin dhe aktivitetet:

- Konfirmimi se aplikuesi, dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuara në Udhëzuesin për Aplikime

(3) Vlerësimi i cilësisë së aplikimit të idesë së biznesit dhe vlerësimi i planit të biznesit dhe të dhënave financiare:

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuara në Tabelat Vlerësuese të Fazës së I-rë dhe të II-të, që janë pjesë përbërëse e këtij dokumenti. Ka dy lloje të kritereve vlerësuese: kriteret e idesë së biznesit, kriteret e planit të biznesit.

Ju lutemi kushtoni vëmendje informacionit në vijim:

Për te dyja fazat kriteret e pikëzimit ndahen në seksione dhe nën-seksione. ***Çdo nën-seksion duhet vlerësuar me pikët e përcaktuara nga 1 në 5 sipas mënyrës së mëposhtme: 1 = shumë i keq; 2 = i keq; 3 = i përshtatshëm; 4 = i mirë; 5 = shumë i mirë***. Çdo anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësimi dhe të gjithë anëtarët nënshkruajnë tabelën përmbledhëse të vlerësimit të aplikimeve. Renditja e aplikimeve bëhet duke u nisur nga aplikimi me numrin më të madh të pikëve, i ndjekur nga aplikimi pasardhës me më pak pikë.

**Shënim për Fazën e 1. Vlerësimi i zhvillimit të idesë së biznesit**

Vlerësimi maksimal për fazën e vlerësimit të zhvillimit të idesë së biznesit është 35 pikë.
Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Fazën e I-rë është më i ulët se 20 pikë, sepse aplikimi i dorëzuar nuk garanton cilësinë e aplikimit.

**Shënim për Fazën e II-të. Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit**

Vlerësimi maksimal për fazën e vlerësimit të planit të biznesit është 65 pikë.

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Fazën 2 është më i ulët se 45 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti garanton cilësinë e aplikimit, aplikimi nuk ofron një analizë të mirëfilltë financiare dhe plani i biznesit nuk është relevant.

Nëse gjatë procesit të vlerësimit konstatohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë. Komisioni do të paraqesë arsye për refuzimin e ideve të biznesit për cdo aplikim.

Për të dyja fazat e vlerësimit, Komisioni rendit vlerësimin e aplikimeve sipas pikëve

përfundimtare. *Të gjithë aplikimet të cilët kanë marrë vlerësime prej 65 pikësh ose më shumë do të pranohen për tu financuar, sipas fondeve në dispozicion.*

**Hapi i parë: Vlerësimi administrativ**

Koordinatori i Skemës asiston në shpërndarjen e të gjithë zarfave të marrë me aplikime, nëpërmjet nënshkrimit të një procesverbali të marrjes në dorëzim. Përpara se të bëhet shqyrtimi i hollësishëm i aplikimeve të dorëzuara, Komisioni kontrollon nëse aplikimet janë dorëzuar brenda kohëzgjatjes së thirrjes.

Më pas, anëtarët e Komisionit dhe Koordinatori hapin të gjithë zarfat**. Në rastin e dublikimeve të aplikimeve (më shumë se një aplikim për person) do të shpallet përfitues vetëm një aplikim, ai që ka idenë më të mirë të biznesit.**

Në rast se aplikimi nuk i plotëson kriteret teknike apo është dorëzuar përtej afateve të thirrjes, ai përjashtohet nga vlerësimi i mëtejshëm dhe shpallet i skualifikuar.

**Hapi i dytë: Vlerësimi teknik dhe përzgjedhja e fituesve të Ideve të Biznesit.**

Pas vlerësimit administrativ do të shqyrtohet përmbajtja e aplikimit të Idesë së Biznesit sipas kritereve të përcaktuara. Anëtarët e Komisionit duhet të bien dakord me rezultatet përfundimtare dhe listën e pranuar të planeve të biznesit për financim.

Koordinatori i skemës vepron si sekretar gjatë takimeve dhe harton procesverbalin e takimeve.

### 12.4 Shpallja e rezultateve

Me përfundimin e procesit, rezultatet përfundimtare të vlerësimit nxirren në faqen e internetit të bashkisë. Për këtë qëllim, bashkia përgatit një pasqyrë në formë tabele të të gjithë aplikantëve dhe pikëve totale të marra nga secili, pa dhënë pikët individuale që ka dhënë secili anëtar i Komisionit.

Secili aplikant do të marrë një *Njoftim* me shkrim (Aneksi 9), të përgatitur nga Koordinatori i skemës dhe të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, sipas komenteve të Komisionit të Vlerësimit.

### 12.5 Pjesëmarrja në trajnim, zhvillim, dhe paraqitja e planëve të biznesit

**Përshkrimi i trajnimit**

Të gjithë të interesuarit do të kenë mundësinë të marrin pjesë në një kurs trajnimi për planifikimin e biznesit të organizuar nga Bashkia, i cili do të zgjasë jo më pak se 1 javë. Aplikantët do të trajnohen njëkohësisht përpara mbylljes së thirrjes dhe individualisht gjatë zbatimit të aplikimit. Trajnuesit dhe mjediset për trajnim do të vihen në dispozicion nga Bashkia. Gjithashtu gjatë zbatimit të projektit, aplikantët mund të konsultohen me trajnuesit

për planet e tyre të biznesit. Trajnimi do të përqendrohet në mënyrën se si të hartohet një plan biznesi për Thirrjen dhe duhet të përdorë *Formatin e Planit të Biznesit* (Aneksi 7) për ushtrime praktike dhe në mënyrën se si duhet të zbatohet ai. Të gjitha datat e takimeve informuese, njoftimet dhe materialet e tjera do të publikohen në faqen e Bashkisë Shkodër.

**Faza II: Plani i biznesit** *(për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.)*

**Formati i Planit të Biznesit**

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të fillojnë të punojnë në planet e tyre të biznesit, duke përdorur *Formatin e Planit të Biznesit* dhe *dokumentet përkatëse* që do t'u dorëzohen secilit kandidat që arrin këtë fazë. Planet e biznesit duhet të zhvillohen dhe dorëzohen jo më vonë se 10 pune pas përfundimit të trajnimeve. Gjatë kësaj periudhe, aplikantët mund të kërkojnë konsulencë nga trajnuesit për planet e tyre të biznesit.

Faza e 2: Dorëzimi i planit të biznesit për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.

1. Plani i Biznesit dhe Financimit sipas modelit të kërkuar;

*Dokumenta shoqërues shtesë pë fazën e II-të:*

- ✓ Dorëzimi i pasqyrave financiare (bilanci) për dy vitet e fundit të aktivitetit të biznesit;
- ✓ Çertifikime/patenta, apo dokumente të tjerë suportues të cilët vërtetojnë elementin inovativ përbëjnë prioritet; (Nëse kanë;)
- ✓ Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëse aplikanti nuk ka detyrime financiare ndaj këtij institucioni (për aplikantët të cilët kanë biznes ekzistues);
- ✓ Dëshmi penaliteti e aplikuesit, lëshuar gjatë muajit të hapjes së thirrjes;

**Dorëzimi i Planeve të Biznesit**

Planët e biznesit duhet të dorëzohen jo më vonë se 10 ditë pune pas përfundimit të trajnimeve.
Planet e biznesit të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm duhet të dorëzohen pranë sportelit të Z1N, në Bashki në tre (3) kopje të printuara dhe një kopje elektronike (në CD ose USB) dorazi, në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar emri i thirrjes publike ***Formular aplikimi për pjesëmarrjen në skemën e granteve për biznese inovative,*** emri i plotë dhe adresa e aplikantit.

Afati i dorëzimit të aplikimeve është **DITA, DATA**, deri në orën 16:00, gjatë ditëve të punës (e hënë deri në të premte), midis orës 08:00 dhe 14:00, në adresën: adresa e bashkisë:

**Zyra me Një Ndalesë (Z1N), Bashkia Shkodër**
**Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1**
**4001, Shkodër**

Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (me postë, faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.

**Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.**

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

- Një verifikim formal i adresës, kryhet në sportelin e Z1N, dokumentet të cila nuk kanë adresë, nuk do të pranohen;
- Çdo kandidati i caktohet një numër reference me datën dhe orën e dorëzimit.

### 12.6 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve të Planeve të Biznesit

Shqyrtimi dhe vlerësimi i Aplikimit *të Planit të Biznesit* (Aneksi 7) do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit të ngritur me urdhër, që në fazën e I-rë. Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhja e kandidatëve do të përfundojë jo më vonë se 5 ditë punë pas afatit përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve *të Planeve të Biznesit*. Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë të pranishëm në takim.

Koordinatori i Skemës shpërndan të gjithë zarfat e marrë me aplikime. Secili anëtar i Komisionit do të vlerësojë secilën ide biznes individualisht si më poshtë:
Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(1) Kushteve administrative:

- Aplikimi është i kompletuar sipas kerkesave të thirrjes.
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).

(2) Kushtet që kanë të bëjnë me Aplikuesin dhe aktivitetet:

- Konfirmimi se aplikuesi, dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuara në Udhëzuesin për Aplikime

(3) Vlerësimi i cilësisë së aplikimit të Planit të biznesit

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuara në Formularin e Vlerësimit që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Kur dokumentet e aplikimit nuk janë plotësuar ose nuk përputhen me kërkesat e thirrjes, aplikantët do të përjashtohen nga konkurimi. Vetëm planet e biznesit që përmbajnë dokumentim të plotë dhe që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë do të pranohen për vlerësim. Ky proces do të përfundojë jo më vonë se 5 ditë punë pas afatit përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve *të Planit të Biznesit*.

***Kriteret për realizueshmërinë e planit të biznesit***

Vlerësimi maksimal është 65 pikë, dhe matet nga elementët e mëposhtëm:

- Realizueshmëria financiare e biznesit;
- Burimet e disponueshme për biznesin – mjediset, pajisjet, furnizimet dhe personeli;
- Menaxhimi i rriskut;
- Njohuritë lidhur me llojin përkatës të biznesit;
- Vlerësimi i tregut.

***Shënim:*** *Vlerësimi total është 100 pikë, prej të cilave 35 pikë vijnë nga Faza I-rë dhe 65 pikë nga Faza II-të.*

*Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të vlerësimit, ka të drejtën të kërkojë që aplikantët që kanë kaluar në fazën e dytë të vlerësimit të paraqesin planet e tyre të biznesit përmes një prezantimi. Pas këtij prezantimi, komisioni do të vijojë me vlerësimin përfundimtar, renditjen e fituesve dhe propozimin për financim.*

### 12.7 Ankesat.

Pas botimit zyrtar të rezultateve, për secilën Fazë, aplikuesit kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin brenda *5 ditësh punë* nga marrja e njoftimit. Të gjitha ankimimet e paraqitura brenda afatit përfundimtar shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, që duhet të informojë aplikantin për vendimin dhe përfundimet e tyre me shkrim brenda pesë ditësh punë. Koordinatori i skemës do të kontaktojë me email ose telefon të gjithë aplikantët për t'i njoftuar me rezultatet e vlerësimit.

Nëse gjatë procesit të vlerësimit konstatohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë.

Pikët përfundimtare për secilën ide biznesi janë mesatarja e pikëve të anëtarëve të Komisionit.

Së fundi, Komisioni rendit aplikantët sipas pikëve përfundimtare të secilës ide biznesi në rendin zbritës (nga aplikanti me pikët më të larta te ai me pikët më të ulëta). (Aplikantët me 65 pikë e lart do të përzgjidhen).

### 12.8 Rishikimi i projektit pas miratimit të grantit.

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, aplikanti që ka pasur sukses në aplikim do të ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, Bashkia Shkodër ka të drejtën ti kërkojë subjektit aplikues modifikime të caktuara në projekt (buxhet dhe planin e biznesit) për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit, pa cenuar thelbin e projekt propozimit.

## 13. Kontraktimi dhe Përdorimi i Fondeve

### 13.1 Kontrata e Grantit

Për aplikantet e shpallur fitues në të dyja fazat, përpara lidhjes së kontratave duhet të dorëzojnë:

- **Bizneset e reja** duhet të kryejnë regjistrimin e tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe të dorëzojnë certifikatën përkatëse para nënshkrimit të kontratës. Pas regjistrimit, bizneset e reja duhet të dorëzojnë vertetimin oigjinal të llogarisë bankare në lek, së bashku me certifikatën e regjistrimit në QKB.
- **Bizneset ekzistuese** duhet të dorëzojnë vërtetimin origjinal të llogarisë bankare në lekë, së bashku me certifikatën e regjistrimit në QKB.
- Çdo dokument që **vërteton pronësinë ose të drejtën e përdorimit të ambienteve**, si dhe **licencat, lejet apo autorizimet e nevojshme** për ushtrimin e aktivitetit.

- **Deklarata De Minimis**

Procesi për regjistrimin e enteve ligjore (vetëm për individët) dhe firmosja e kontratës së grantit do të koordinohet nga Drejtoria e Pergjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit. Pas regjistrimit, të gjithë aplikantët e miratuar duhet të hapin një llogari bankare në emër të biznesit të tyre. (llogari biznesi).

Kandidatët duhet të dorëzojnë çdo dokument që vërteton pronësinë ose të drejtën e përdorimit të ambienteve, si dhe licencat, lejet apo autorizimet e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit dhe më pas nënshkruajnë kontratën e grantit. Kontrata e standardizuar e grantit firmoset ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe përfituesit për një periudhë kohore prej **6 deri në 9 muaj** që nga dita e nënshkrimit. Plani i Biznesit dhe të gjitha bashkëlidhjet e miratuara nga Komisioni Vlerësues do të përbëjnë një pjesë integrale të Kontratës së dhënies së grantit (Aneksi 10).

Gjatë zbatimit të kontratës, bizneset fituese mund të dorëzojnë kërkesën për amendimin e kontratës. Ndryshimet mund të bëhen vetëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratës dhe nuk do të kenë fuqi prapavepruese. Ndryshimet e miratuara do të integrohen në një aneks të firmosur nga palët i cili do të përbëjë një pjesë integrale të kontratës.

Bashkia e Shkodrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të buxhetit të përcaktuar në aplikim, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate.
Aplikanti i miratuar duhet ta përdorë grantin **brenda periudhës 6 deri në 9 (nëntë) muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit.

Pas lidhjes së Kontratës së grantit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe përfituesit të grantit do të ngrihet dhe Grupi i Monitorimit për zbatimin e këtij Granti.

***Ky grup do të ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Shkodër.***

## 14. Monitorimi dhe Vlerësimi

Për të ndjekur ecurinë e zbatimit të projektit fitues dhe për efekt monitorimi, është e nevojshme të krijohet një dosje për secilin projekt, ku përmban të dhënat administrative dhe financiare. Në këtë dosje duhet të arkivohen të gjitha **faturat origjinale** dhe dokumentet e tjera që lidhen me aplikimin.

Qëllimi i monitorimit të skemës, që mbulohet nga ky Udhëzim i Aplikimit, është të sigurojë:

1. Informacion në kohë dhe të saktë nëse skema është duke u zbatuar në përputhje me objektivat dhe kalendarin e tij;
2. Monitorimin e suksesit dhe efekteve të skemës së zbatuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik do të monitorojë zbatimin në kohë të kontratave duke filluar nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundim të tij, sipas *Udhëzuesit për zbatimin e projekteve*, dokument i cili do të miratohet nga Kryerari i Bashkisë.

Grupi i Monitorimit do të monitorojnë suksesin dhe efektet e zbatimit të skemës duke vizituar aplikantët e pranuar në këtë skemë grantesh. Vizitat në terren duhet të organizohen ( kur

nevojitet) duke bërë përcaktimin paraprak të përfituesve, si dhe duke i njoftuar ata brenda një afati nga një deri në tre ditë përpara vizitës së planifikuar. I gjithë informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren do të reflektohet në një *Formular Monitorimi* (Aneksi 12). Punonjësit do të diskutojnë dhe marrin vendim për të gjitha vëzhgimet dhe çështjet e identifikuara gjatë vizitave në terren.

Ekspertet dhe trajneret për mbështetjen e biznesit do të përdoren si një burim informacioni kur përgatiten vizitat monitoruese.

Gjatë vizitave në terren, do të kontrollohen elementët e mëposhtëm të përmbushjes së qëllimeve të Skemës, të cilat do të parashtrohen me detaje në *Formularin e Monitorimit*:

- Ecuria e aktiviteteve në krahasim me planin e biznesit;
- Ndjekja e kalendarit të përdorimit të grantit dhe kontributit të aplikantit;
- Organizimi i biznesit;
- Verifikimi dhe dobia e shpenzimeve;
- Ndikimi i përdorimit të grantit, etj.

Një raport përfundimtar për projektin do të hartohet nga grupi i punes per monitorimin e kontratave në fund të zbatimit, duke përfshirë një analizë dhe rekomandime për ndryshimet.

***Tregues të Performancës së Skemës së Granteve***

Treguesit e mëposhtëm statistikorë do të monitorohen gjithashtu gjatë zbatimit të skemës:

- Numri i dorëzuar i aplikimeve;
- Numri i përfituesve të trajnuar;
- Numri i kontratave të firmosura të grantit;
- Sektorët ekonomikë në të cilat funksionojnë bizneset;
- Numri i vendeve të hapura të punës gjatë procesit të realizimit të idesë së biznesit;

Këta tregues do të monitorohen gjatë çdo cikli Skeme Granti, si dhe për të gjithë Thirrjen. Analiza krahasuese e rezultateve të arrira në çdo cikël pasues do të ofrojë informacion mbi dinamikën e Skemës dhe ecurinë e saj.

Skema do të vlerësohet pasi mbyllet cikli i Skemës së Grantit sipas treguesve të mëposhtëm:

- Numri total i bizneseve të mbështetura;
- Numri vendeve të punës të hapura;
- Arsyet për mbylljes së bizneseve (nëse ka raste të tilla);
- Linjat e reja të biznesit të hapura brenda bizneseve ekzistuese;
- Përqindja e bizneseve që funksionojnë pas një viti punë;
- Investime të reja (aktivitete biznesi/linja biznesi shtesë, biznese të reja, etj.);

**Dokumentacioni i dërguar për likuidim.**

Vetëm pas realizimit të shpenzimeve, përfituesi i grantit do të dorëzojë kërkesën për likuidim shpenzimesh, e shoqëruar me dokumentacionin narrativ dhe financiar i cili vërteton përkatësinë e shpenzimeve sipas parashikimeve të planit të aktiviteteve. Përfituesi i grantit do të dorëzojë:

- Faturë dhe pagesat bankare (konfirmim pagese ose urdhër pagese) për secilën blerje;
- Situacioni;

- Kontrata ndërmjet biznesit dhe punonjësit;
- Listpagesa në formatin e deklarimit tatimor ose Formulari E- SIG për stafin;
- Dokumentet origjinale të firmosura nga banka për pagesën e pagës neto, kontributeve në llogari të punonjësit, dhe komision bankar.

Bashkia Shkodër, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik, do të kryejë monitorimin përkatës për çdo kontratë granti të nënshkruar dhe ka të drejtën të bëjnë inspektime në terren për të monitoruar, verifikuar apo dhe për të kërkuar dokumentacion shtesë për të vërtetuar të dhënat e raportura nga përfituesi i grantit. I gjithë informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren do të reflektohet në raportimet e ndërmjetme ose finale.

Pas hartimit të raportit ndërmjetëm/final të monitorimit dhe verifikimit të dokumentacionit të sjellë nga përfituesi i grantit Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik dërgon kërkesën për likuidim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, e cila përmban:

- Urdhër për ngritjen e grupit të monitorimit për projektet e shpallura fituese;
- Raport i ekipit të monitorimit;
- Raport narrativ dhe financiar i biznesit;
- Faturë dhe situacion;

Nëse aplikanti e përdor grantin për qëllime të tjera, por jo për biznesin e miratuar ose përfundon aktivitetin e biznesit pa një arsye objektive, Bashkia do të ndalojë menjëherë së financuari atë biznes dhe/ose do të fillojë një procedurë në gjykatën përkatëse për rikthimin e grantit.

Pas përfundimit të afatit të kontratave dhe përmbylljes së procesit të hartimit të raportit final, Grupi i Monitorimit përgatit një *raport përmbledhës* drejtuar Kryetarit të Bashkisë, i cili pasqyron mbarëvajtjen e zbatueshmërisë së kontratave të grantit.

## 15. Zbatimi i Skemës së Granteve për vitet e ardhshme

Procedurat e parashikuara të këtij udhëzuesi të Aplikimit janë të zbatueshme, në parim, edhe për vitet e ardhshme, në rast se kjo skemë do të financohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër dhe/ose burime të tjera financiare. Fusha e zbatimit të skemës dhe numri i përfituesve për vitet pasardhëse do të përcaktohet në varësi të buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm. Procedurat e lartpërmendura do të vihen në zbatim, pas miratimit të aktit nga institucioni përgjegjës shtetëror që autorizon dhënien e ndihmës shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi.

## 16. Anekset

Aneksi 1 – Njoftim Publik
Aneksi 2 – Njoftim për Takimet Informuese
Aneksi 3 – Formular Aplikimi për Ide Biznesi
Aneksi 4 – Formulari individual i Vlerësimit
Aneksi 5 – Formulari Përmbledhës i Vlerësimit
Aneksi 6 – Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimeve
Aneksi 7 – Formati i Planit të Biznesit
Aneksi 8 – Procesverbal i mbylljes së Thirrjes së hapur publike
Aneksi 9 – Njoftim për Aplikantët
Aneksi 10 – Kontrata për Dhënien e Grantit
Aneksi 11 – Raporti Narrativ (për subjektet), raporti financiar dhe situacioni
Aneksi 12 – Formular Monitorimi
Aneksi 13 – Deklarata e paanshmërisë dhe konfidencialitetit
Aneksi 14 – Formular për konfirmimin e marrjes në dorëzim të dokumentacionit
Aneksi 15 – Kërkesë për likuidim shpenzimesh
Aneksi 16 – Deklarata për plotësimin e kritereve
Aneksi 17 – Deklarata De minimis
Aneksi 18 – Listë Kontrolli e Dokumenteve

**Aneksi 1 – Njoftim Publik**

**Njoftim Publik**

Bashkia Shkodër shpall thirrjen e hapur 'Skemë granti për bizneset inovative', e financuar nga burime publike, për dorëzimin e aplikimeve për grante.

**1.2 Qëllimi i Thirrjes**

Qëllimi i kësaj thirrje është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga sipërmarrësit aspirantë dhe zhvillimin e bizneseve ekzistuese, të cilat synojnë të shndërrohen në biznese inovative përmes zbatimit të ideve, produkteve, shërbimeve apo proceseve inovative, të cilat rrisin konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në treg.

Skema do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

**1.3 Mbështetja e Skemës**

Skema e granteve synon të mbështesë sipërmarrësit aspirantë në zhvillimin e ideve të biznesit të suksesshme dhe testimin e tyre për të tejkaluar vështirësitë e ndryshme të tregut. Për këtë qëllim, Bashkia Shkodër do të organizojë takime informuese ("ditë të hapura") me të gjithë individët e interesuar ku do të informohen në detaje rreth thirrjes së shpallur, mënyrës së aplikimit, kriteret, etj.

Për të siguruar që aplikimet të jenë të plota dhe korrekte, Bashkia Shkodër do të ofrojë gjithashtu trajnime mbi hartimin e planeve të biznesit gjatë periudhës së thirrjes.

Në rastin kur fitues janë individë, përfitimi i grantit kushtëzohet nga regjistrimi i biznesit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Vetëm pas këtij regjistrimi, bizneset mund të nënshkruajnë kontratën me Bashkinë Shkodër.

Pas nënshkrimit të kontratës, fituesit do të përfitojnë seanca mentorimi nga Bashkia Shkodër, për të ofruar asistencë teknike gjatë fazës së zbatimit të projekteve.

**1.4 Aplikantët e Pranueshëm**

Aplikantët e pranueshëm për këtë Thirrje **janë shtetas shqiptarë mbi moshën 18 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide biznesi ose kanë një biznes ekzistues dhe synojnë ta shndërrojnë atë në një biznes inovativ.**

Thirrja është e hapur për këto kategori:

***Sipërmarrësit Aspirantë:*** Individë që kanë ide për të filluar një biznes të ri dhe kërkojnë mbështetje për të realizuar këto ide.

***Bizneset ekzistuese:*** Biznese ekzistuese me qarkullim vjetor $\leq$ 8,000,000 lekë/vit [8] që

[8] Ligji nr .9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar.

kërkojnë të zgjerohen, të modernizohen ose të implementojnë praktika të qëndrueshme dhe inovative.

Aplikantët inkurajohen të marrin pjesë personalisht në të gjitha aktivitetet e parashikuara në kuadër të kësaj Thirrjeje, përfshirë sesionet informuese, trajnimet, mentorimet dhe aktivitetet e tjera të organizuara. Pjesëmarrja aktive konsiderohet një element i rëndësishëm për përfitimin maksimal nga programi dhe për zbatimin me sukses të ideve dhe planeve të biznesit.

Ato që nuk përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur janë ato të cilat kanë konflikt interesi me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e skemës së granteve. Për këtë aplikantët duhet të nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit.

Aplikantët mund të marrin pjesë në thirrje vetëm me 1 (një) ide biznesi.

### 1.5 Aktivitete biznesi të pranueshme

Aktivitetet e pranueshme për biznes janë nga sektorët e mëposhtëm, përkatësisht:

- IT;
- Inteligjencë artificiale;
- Turizëm/ Agroturizëm;
- Mjedis;
- Energji e rinovueshme;
- Shërbime/Prodhim;
- Artizanat;
- Marketing;
- Teknologjia e informacionit dhe zhvillimit.

Sektorët mund të ndryshojnë gjatë vitit, në varësi të prioriteteve të parashtruara nga Bashkia.

Nëse kandidatët do të jenë në kushte të barabarta, prioritet do t'i jepet aplikantëve:

- Me ide të veçantë për biznes (jo e përsëritur nga aplikantët e tjerë), ose të cilët ofrojnë produkte ose shërbime të reja;
- Të cilët përdorin zgjidhje teknike dhe teknologji prodhimi të reja, ose që kursejnë energji;
- Të cilët përdorin procese inovative;
- Me biznese që krijojnë të paktën dy vende pune.

Pavarësisht sektorit të përzgjedhur, idetë e mëposhtme për biznes nuk janë të pranueshme për të marrë pjesë në skemë:

- Veprime me pasuri të patundshme, dhënia me qira e pasurive të patundshme;
- Veprime financiare sigurimi apo operacione që përfshijnë bixhozin;
- Prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë alkooli dhe pijeve alkoolike të fuqishme;
- Prodhimi i produkteve të duhanit;
- Prodhimi dhe shpërndarja e armëve;

- Prodhimi që përdor teknologjinë që shkakton ndotje mjedisore (si për shembull ndotje të ajrit, ujit, tokës, etj.)
- Ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës.

### 1.6 Mbështetje financiare

Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar çdo vit për Bashkinë Shkodër për thirrjen "Skemë granti për bizneset inovative".

Aplikantët e përzgjedhur duhet të bashkëfinancojnë **20%** të shumës së grantit por mund të planifikojnë edhe financime të tjera shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, dhënie me qira, grante, etj.) të disponueshme në Shqipëri përmes institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë, ose financat e veta. Ky burim financimi duhet të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit. Nëse instrumenti financiar do të përdoret për zgjerim të mëtejshëm të biznesit, kjo mbështetje e mëtejshme e marrë pritet që të raportohet në vizitat dhe raportet monitoruese për skemën e granteve.

### 1.7 Shpenzimet e pranueshme nga skema

Shpenzimet e pranueshme që mund të mbulohen nga fondi i grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit të paraqitur dhe mund të përfshijnë:

- Blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme të cilat do të shërbejnë për të diversifikuar prodhimin me produkte të reja ose një ndryshim rrënjësor në proçesin e përgjithshëm të prodhimit të këtyre produkteve;
- Shpenzime për asete të tjera të paprekshme (licenca, markim dhe patentim produktesh);
- Pagat dhe sigurimet do të mbulohen vetëm për të punësuarit që lidhen drejpërdrejt me procesin e prodhimit të produkteve/shërbimeve, deri në 3 muajt e parë nga fillimi i aktivitetit të biznesit por pa tejkaluar më shumë se 20% të grantit.

### Shpenzime të panjohura nga skema

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga fondi i grantit përfshijnë:

- Shpenzimet e lindura/krijuara përpara nënshkrimit të kontratës së grantit;
- mirëmbajtje dhe riparime;
- blerjen e pasurive të patundshme (tokë, godina, etj.);
- blerjen e mjeteve të transportit
- çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar;
- zbavitje dhe dhurata.

Shpenzimet jo të pranueshme në grant mund të mbulohen nëpërmjet kontributit personal të aplikantit, dhe formave të tjera të financimit, te cilat nuk janë pjesë e fondeve që vendos në dispozicion Bashkia Shkodër.

Në rastin e fituesit, kalimi i fondit në palë të treta është i ndaluar.

**1.8 Si të Aplikoni**

Të gjithë Formularët e plotësuar të Aplikimit do të dorëzohen në Sektorin e Z1N në Bashki **në tre kopje origjinale dhe nje kopje eletronike në CD/USB**. Aplikantët janë të detyruar që të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Afati i fundit për dorëzim nuk është **më vonë se ___/___/___** ora ___(data dhe ora).

**Çdo aplikim që merret pas datës së shpallur të mbylljes do të quhet i pavlefshëm.**

**Çdo aplikant mund të aplikojë me vetëm një ide për biznes**.

**1.9 Dokumentacioni i cili duhet dorëzuar për aplikim:**

Faza e 1: Dorëzimi i aplikimit të ideve të biznesit;

1. Formulari i aplikimit për ide biznesisipas modelit të kërkuar;
2. Kopja e kartës së identitetit të Aplikantit;
3. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), për bizneset ekzistuese;
4. Vertetim xhiro për 3 vitet e kaluara nga e-albania për bizneset ekzistuese;
5. Vërtetim për saktësim adrese.

Faza e 2: Dorëzimi i planit të biznesit *(për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.)*

1. Plani i Biznesit dhe Financimit sipas modelit të kërkuar;
2. Dorëzimi i pasqyrave financiare (bilanci) për dy vitet e fundit të aktivitetit të biznesit;
3. Çertifikime/patenta, apo dokumente të tjerë suportues të cilët vërtetojnë elementin inovativ përbëjnë prioritet; (Nëse kanë;)
4. Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëse aplikanti nuk ka detyrime financiare ndaj këtij institucioni; (për aplikantët të cilët kanë biznes ekzistues);
5. Dëshmi penaliteti e aplikuesit, lëshuar gjatë muajit të hapjes së thirrjes;

Për aplikantet e shpallur fitues në të dyja fazat, përpara lidhjes së kontratave duhet të dorëzojnë:

- **Bizneset e reja** duhet të kryejnë regjistrimin e tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe të dorëzojnë certifikatën përkatëse para nënshkrimit të kontratës. Pas regjistrimit, bizneset e reja duhet të dorëzojnë vertetimin oigjinal të llogarisë bankare në lek, së bashku me certifikatën e regjistrimit në QKB.
- **Bizneset ekzistuese** duhet të dorëzojnë vërtetimin origjinal të llogarisë bankare në lekë, së bashku me certifikatën e regjistrimit në QKB.
- Çdo dokument që **vërteton pronësinë ose të drejtën e përdorimit të ambienteve**, si dhe **licencat, lejet apo autorizimet e nevojshme** për ushtrimin e aktivitetit.
- **Deklarata De Minimis**

Të gjithë aplikantët duhet t'i qëndrojnë në mënyrë rigoroze formatit të aplikimit dhe formateve të bashkëngjitura në këtë udhëzim.

**Informacione të tjera**

Paketa e plotë e aplikimit dhe informacione shtesë mund të gjenden në adresën www.bashkiashkoder.gov.al
Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni në **Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit** nëpërmjet adresës së e-mail: planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al

**Takimet informuese do të organizohen më .................. (datë) nga .................... (ora) në ................. (vendi, adresa).**

**Aneksi 2 – Njoftim i Takimeve Informuese**

**Njoftim i Takimeve Informuese/trajnimeve**

Bashkia Shkodër ju fton të merrni pjesë në një takim informues që do të zhvillohet në datën ..........., nga ora ..... deri në ........................., në kuadër të thirrjes "Skemë granti për bizneset inovative".

Gjatë këtij takimi do të prezantohet skema e grantit, e cila u drejtohet të gjithë shtetasve shqiptarë mbi moshën 18 vjeç, banorë të Bashkisë Shkodër, që kanë një ide biznesi ose një biznes ekzistues dhe synojnë të zhvillojnë, përmirësojnë apo zbatojnë procese, produkte ose shërbime inovative.

Nëse mendoni se keni një ide biznesi të suksesshme dhe nuk keni mbështetje financiare, mos hezitoni të aplikoni! Thirrja e Bashkisë Shkodër për bizneset inovative ofron një mundësi për të financuar idenë tuaj të biznesit si dhe ju ofron trajnim intensiv në planifikim biznesi, aftësi në biznes, kërkim për mbështetje të tjera financiare dhe konsultime me këshillues të njohur të fushës.

Fondi për *"Skemë granti për bizneset inovative"* është projekt i Bashkisë Shkodër i financuar nga fondet e veta.

Skema zbatohet përmes një procesi konkurrues, i cili garanton transparencë dhe konkurrencë të barabartë, duke mbështetur idetë dhe planet e biznesit më cilësore dhe inovative që sigurojnë rezultate të qëndrueshme.

Informacion të detajuar mbi thirrjen, si dhe paketën e plotë, mund ta gjeni në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër në adresën www.bashkiashkoder.gov.al, ose duke kontaktuar në adresën e email-it planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al.

Të gjithë të interesuarit janë të ftuar të marrin pjesë në takimin informues.

**Aneksi 3 –Formulari i Aplikimit**

## FORMULARI I APLIKIMIT

## I. INFORMACIONE KONTAKTI

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | |
| **Përshkrimi i projektit në një fjali** | |
| **Emri i aplikuesit** | |
| **Statusi ligjor** | ☐ Individ (i paregjistruar)<br>☐ Biznes ekzistues (i regjistruar) |
| **Numri personal i identifikimit** | *(NID i aplikantit)* |
| **NIPT-i i biznesit** | *(nëse është e aplikueshme)* |
| **Adresa** | *(Individët japin adresën personale, ndërsa bizneset adresën e vendndodhjes së tyre.)* |
| **E-mail** | |
| **Website** | *(nëse është e aplikueshme)* |
| **Numri i telefonit** | |
| **Niveli i arsimit, fusha e arsimit** | |
| **Profesioni** | |
| **Buxheti total i projektit**[9] | *(vlera në lekë)* |
| **Kohëzgjatja e projektit** | |
| **Kontributi i vetë aplikantit** [10] | *(Min. 20% e financimit të kërkuar, e shprehur në lekë)* |
| **Shuma e kërkuar e financimit** | *(vlera në lekë)* |

## II. TË DHËNAT PËR BIZNESIN

| | |
|---|---|
| **Numri i punonjësve të regjistruar** | *(Nëse ka)* |
| **Sektori ku operon** | ☐ IT |

[9] Ky duhet te jete buxheti total i projektit

[10] Këtu duhët të përcaktohet shuma e co-financuar nga aplikanti. Për fazat dhe tipologjitë e pranuara te co-financimit referohuni dokumentit të rregullores së skemës së granteve.

| | |
|---|---|
| | ☐ Turizëm<br>☐ Energji<br>☐ Agro<br>☐ Tregtia elektronike<br>☐ Prodhim<br>☐ Edukim<br>☐ Inteligjenca Atrificiale<br>☐ Shërbime Biznesi<br>☐ Mjedisi<br>☐ Marketing<br>☐ Tjetër |

## III. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

**Jepni një përshkrim të shkurtër të idesë tuaj të biznesit:**
*Përshkruani shkurtimisht çfarë biznesi planifikoni të krijoni, çfarë problemi zgjidh ose çfarë nevoje plotëson dhe cili është qëllimi kryesor i tij.*

**Biznesi im do të ofrojë produktet/shërbimet e mëposhtme:**
*Listoni dhe përshkruani produktet ose shërbimet që do të ofroni, duke përfshirë karakteristikat kryesore dhe vlerën që ato i sjellin klientit.*

**Do të shes produktet/shërbimet e mia në (përshkruani tregun tuaj):**
*Përshkruani tregun ku do të operoni, grupin e synuar të klientëve (mosha, vendndodhja, nevojat), si dhe mënyrën se si do t'i arrini ata.*

**Konkurrenca ekzistuese dhe avantazhi konkurrues i biznesit tim:**
*Identifikoni konkurrentët kryesorë në treg dhe shpjegoni se çfarë e dallon biznesin tuaj prej tyre (çmimi, cilësia, shërbimi, inovacioni, lokacioni, etj.).*

**Aftësitë, përvojat dhe njohuritë që zotëroj për të zhvilluar këtë biznes:**[11] *Përshkruani aftësitë profesionale, përvojën e mëparshme, njohuritë teknike apo menaxheriale që keni dhe që ju ndihmojnë në realizimin e këtij projekti. Specifikoni ekipin tuaj dhe rolin e secilit anëtar të ekipit, nëse ka. A përfshin sipërmarrës nga diaspora apo të punësuar të cilët janë kthyer nga emigracioni?*

[11] Ju lutemi bashkangjisni edhe dokumente shtesë që vërtetojnë arsimin, aftësitë dhe eksperiencat e sipërpërmendura.

**Zgjodha këtë ide biznesi sepse:**

*Shpjegoni arsyet pse keni zgjedhur këtë ide, motivimin personal, mundësitë që shihni në treg dhe pse besoni se kjo ide ka potencial për sukses.*

*Unë i/e nënshkruara ___________________ me nr. ID ___________________ banuese në Shkodër, adresa; ____________________________deklaroj se të dhënat që përmban ky aplikim janë dhënë me vullnetin time të lirë, në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale, të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i cili garanton konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe në këtë mënyrë jap shprehimisht pëlqimin tim që ato të përdoren nga Bashkia e Shkodrës për qëllime të kryerjes së aktivitete të saj.*

Nënshkroi: ___________________ Data ___/____/202__

**Aneksi 4 Formulari individual i vlerësimit**

**Aplikanti: ________________________________________**

☐ **Individ (i paregjistruar)** ☐ **Biznes ekzistues (i regjistruar)**

| Kriteret | Vlerësimi | Vlerësimi |
|---|---|---|
| **Faza 1: Zhvillimi i idesë së Biznesit** | **35/20** | |
| A është aplikimi i formuluar qartë dhe në përputhje me kriteret e thirrjes? | 5 | |
| A janë rezultatet e pritshme afatgjata dhe a kontribuojnë në ekonominë lokale? | 5 | |
| A përfshin aplikimi produkte/shërbime dhe procese inovative? | 5 | |
| A përfshin aplikimi qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë për bizneset e tjera? | 5 | |
| A parashikon aplikimi bashkëpunim me aktorë lokalë apo biznese të tjera? | 5 | |
| A bën projekti avokim për barazinë gjinore dhe nxitjen e të rinjve në punësim dhe sipërmarrje? | 5 | |
| A përfshin sipërmarrës nga diaspora apo të punësuar të cilët janë kthyer nga emigracioni? | 5 | |
| **Faza 2: Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit** | **65/45** | |
| A është buxhetimi i qartë dhe i saktë mes kostove të personelit, aktiviteteve dhe vizibilitetit? | **5** | |
| A janë identifikuar nevojat e konsumatorëve për produkte/shërbime inovative? | 5 | |
| A është analiza e tregut e detajuar dhe e saktë? | 5 | |
| A është identifikuar dhe analizuar në mënyrë të plotë konkurenca? | 5 | |
| A janë të ardhurat reale (totali i të ardhurave, të ardhurat sezonale, rritja e shitjeve) dhe fitimi neto real? | 5 | |
| A është specifikuar qartë ekipi i ndërmarrjes dhe numri i punonjësve? | 5 | |
| A është identifikuar qartë cili është modeli i të ardhurave, tregu i synuar dhe kush janë klientët? | 5 | |
| A janë shpenzimet e sugjeruara të nevojshme dhe të justifikuara për zbatimin e aplikimit? | 5 | |
| A krijon aplikimi hapjen e të paktën dy vendeve të reja të punës? | 5 | |
| A ka aplikanti kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën përkatëse) ? | 5 | |
| A ka ofruar aplikanti dokumentacionin që ka lidhje me lincencen, marken, patentën e produkteve të biznesit? | 5 | |
| A është bërë planifikimi i menaxhimit të riskut dhe qëndrueshmërisë së biznesit, duke identifikuar dhe menaxhuar rreziqet kryesore? | 5 | |
| A ka aplikanti ambiente të gatshëm për zhvillimin e idesë së biznesit? | 5 | |
| **TOTALI (Faza 1 + Faza 2)** | **100** | |

Nënshkroi: ___________________ Datë ___/____/202__

**Aneksi 5: Formulari përmbledhës i vlerësimit**

**Aplikanti: ______________________________________________** Data ___/____/202__

| **Kriteret** | **Vlerësimi** | **Mesatar** |
|---|---|---|
| **Faza 1: Zhvillimi i idesë së Biznesit** | **35/20** | |
| A është aplikimi i formuluar qartë dhe në përputhje me kriteret e thirrjes? | 5 | |
| A janë rezultatet e pritshme afatgjata dhe a kontribuojnë në ekonominë lokale? | 5 | |
| A përfshin aplikimi produkte/shërbime dhe procese inovative? | 5 | |
| A përfshin aplikimi qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë për bizneset e tjera? | 5 | |
| A parashikon aplikimi bashkëpunim me aktorë lokalë apo biznese të tjera? | 5 | |
| A bën projekti avokim për barazinë gjinore dhe nxitjen e të rinjve në punësim dhe sipërmarrje? | 5 | |
| A përfshin sipërmarrës nga diaspora apo të punësuar të cilët janë kthyer nga emigracioni? | 5 | |
| **Faza 2: Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit** | **65/45** | |
| A është buxhetimi i qartë dhe i saktë mes kostove të personelit, aktiviteteve dhe vizibilitetit? | **5** | |
| A janë identifikuar nevojat e konsumatorëve për produkte/shërbime inovative? | 5 | |
| A është analiza e tregut e detajuar dhe e saktë? | 5 | |
| A është identifikuar dhe analizuar në mënyrë të plotë konkurenca? | 5 | |
| A janë të ardhurat reale (totali i të ardhurave, të ardhurat sezonale, rritja e shitjeve) dhe fitimi neto real? | 5 | |
| A është specifikuar qartë ekipi i ndërmarrjes dhe numri i punonjësve? | 5 | |
| A është identifikuar qartë cili është modeli i të ardhurave, tregu i synuar dhe kush janë klientët? | 5 | |
| A janë shpenzimet e sugjeruara të nevojshme dhe të justifikuara për zbatimin e aplikimit? | 5 | |
| A krijon aplikimi hapjen e të paktën dy vendeve të reja të punës? | 5 | |
| A ka aplikanti kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën përkatëse) ? | 5 | |
| A ka ofruar aplikanti dokumentacionin që ka lidhje me lincencen, marken, patentën e produkteve të biznesit? | 5 | |
| A është bërë planifikimi i menaxhimit të riskut dhe qëndrueshmërisë së biznesit, duke identifikuar dhe menaxhuar rreziqet kryesore? | 5 | |
| A ka aplikanti ambiente të gatshëm për zhvillimin e idesë së biznesit? | 5 | |
| **TOTALI (Faza 1 + Faza 2)** | **100** | |

Anëtarët e Komisionit:

_____________________ _____________________ _____________________

_____________________ _____________________

**Aneksi 6 – Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimit**

**Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimit**

Më ___/___./202__ (data) Komisioni i Vlerësimi u mblodh dhe shqyrtoi _________________ (numri) aplikime, të ardhura deri __________ (ora) më __________ (data),

Aplikimet e dorëzuara nga individ (të paregjistruar) janë ___ (numri).
Aplikimet e dorëzuara nga biznese ekzistuese (të regjistruar) janë ___ (numri).

Gjatë shqyrtimit të aplikimeve, Individët/bizneset ekzistuese të mëposhtme rezultuan të papranueshme sipas kritereve të vendosura në thirrjen *'Skemë granteve për bizneset inovative'* në Bashkinë Shkodër:

| **Nr.** | **Emri i aplikantit** | **Arsyet e mospranimit** |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |

Në bazë të kritereve dhe pikëve të mbledhura për vlerësim, aplikimet e pranuara nga individët dhe bizneset ekzistuese u vlerësuan si më poshtë:

| **Nr.** | **Emri i Aplikantit** | **Pikët totale** | **Vendimi përfundimtar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Sipas rregullave të skemës së granteve të Bashkisë Shkodër, nëse një prej aplikantëve të pranuar nuk paraqitet për firmosjen e kontratës, vendi i tij do të zihet nga aplikantët pasardhës në renditje.

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit:

1. _________________ 2. _________________ 3. _________________

4. _________________ 5. _________________

**Aneksi 7 - FORMULAR PËR PLAN BIZNESI**[12]

## Biznesi

**Emri i Biznesit:** *Shëno emrin e biznesit siç është regjistruar. Nëse nuk e keni regjistruar emrin e biznesit, shtoni emrin e propozuar të biznesit*

**Vendndodhja e Biznesit:** *Vendndodhja e biznesit*

**Data e themelimit:** *Data kur (do të) keni filluar aktivitetin*

**Forma e biznesit:** *Person fizik/juridik*

**Pronari (et) e biznesit:** *Shëno të gjithë pronarët e biznesit, nëse ka.*

**Përvoja Relevante e Pronarit:** *Përshkruani shkurtimisht përvojën tuaj dhe / ose vitet në fushën e biznesit dhe arritjet kryesore*

**Produktet/Shërbimet:** *Çfarë Produktesh/Shërbimesh shisni*

## Tregu

**Rajoni i tregut:** *Në cilen zonë do të shisni, rajon, gjithë vendin, eksport?*

**Klientët:** *Kujt ju po i shisni? Sa klientë të tillë janë në rajonin tuaj të tregut?*

**Vlera për konsumatorin:** *Listoni tre arsye pse klienti do të blejë produktin / shërbimin tuaj?*

**Kapaciteti i shitjeve:** *Sa planifikoni të shisni në vit dhe cilat janë të ardhurat nga kjo?*

[12] Plotësojeni këtë faqe si hap i fundit, jo më shumë se 300 fjalë për këtë kapitull. Fokusohuni pse biznesi juaj do të jetë i suksesshëm.

## TREGU

**Jo më shumë se 2 faqe**

### Produktet/Shërbimet

*Përshkruani produktet ose shërbimet duke qenë i qartë se çfarë nënkuptoni me to. Shpjegoni se si do të filloni me një produkt minimal të qëndrueshëm dhe hap pas hapi ta zhvilloni atë në idenë tuaj përfundimtare të biznesit.*

### Klientët e synuar

*Përshkruani llojin e klientëve që synoni (bizneset e tjera ose konsumatorët e drejtpërdrejtë, mosha tipike dhe të ardhurat e tyre). Përshkruani shkurtimisht faktet kryesore në lidhje me profilin tuaj të klientit. Dhe shtoni nëse ata do të jenë më shumë në të ardhmen.*

### Madhësia e Tregut

*Cila është zona për të cilën doni të shisni dhe cila është sasia totale e produkteve dhe shërbimeve të ngjashme në zonë? Nëse produktet/shërbimet tuaja janë të reja për këtë zonë, deklaroni kërkesën e pritshme dhe shpjegoni se si arrini në këtë shifër të kërkesës.*

*Ju gjithashtu mund të përdorni tabelën më poshtë. Kjo tabelë mbulon seksionet Produkt / shërbime, Konsumatorët e synuar dhe madhësine e tregut.*

| Produkt/sherbim | Klienti Tipik | Kërkesa për vitin e shkuar |
|---|---|---|
| **1.** | | |
| **2.** | | |
| **3.** | | |
| **…** *shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | |

### Konkurentet

| Emri i konkurentit | Pikat e forta/dobësitë | Avantazhet ndaj konkurentit |
|---|---|---|
| Emri i biznesit | Shenoni tre pikat më të forta të konkurentit | Çfarë e bën biznesin tuaj me të mirë se të konkurentit? |
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| … *shto me shumë rreshta nëse nevojitet* | | |

## Analiza SWOT

Shënoni në tabelë në cilat nga këto elementë jeni më të fortë ose më të dobët ju dhe konkurrentët tuaj.

| Pikat e forta | Mundësitë |
|---|---|
| | |
| **Pikat e dobta** | **Rreziqet** |
| | |

Tani përshkruani shkurtimisht se si planifikoni të përdorni pikat e forta, të eliminoni dobësitë tuaja, të eksploroni mundësitë dhe të lehtësoni kërcënimet (rreziqet).

## MARKETINGU

**Jo më shumë se 2 faqe**

### Shitjet Unike

Përshkruani çfarë e bën dallimin midis ofertës suaj të produktit / shërbimit dhe te konkurrentëve tuaj. Cilat janë përfitimet që ju i ofroni klientëve tuaj dhe të tjerët jo?

### Çmimi i shitjes

Ofroni çmimet mesatare te shitjes ne treg per produkte/shërbime te ngjashme.

| Produkt/sherbim | Njësi | Cmimi i shitjes së konkurentit | Cmimi juaj i shitjes |
|---|---|---|---|
| 1. | | | |
| 2. | | | |
| 3. | | | |
| ….. *shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | |

### Strategjia e marketingut dhe promocionit

*Specifikoni mjetet që dëshironi të përdorni për të pozicionuar produktin / shërbimin tuaj në treg dhe t'i bëni klientët të vetëdijshëm për ofertën tuaj, p.sh. media e shkruar, radio, TV, marketing online, media sociale, dosje, postera, reklama në natyrë ...). Pastaj shkruani çfarë prisni, sa e përdorni gjatë një viti dhe kush do te ishin aktoret ne treg.*

Së fundi, poshtë tabelës, jepni buxhetin e planifikuar vjetor të marketingut.

| Promocioni i planifikuar/lloji i marketingut | Rezultatet e pritshme | Kosto mujore | Frekuenca |
|---|---|---|---|
| **1.** | | | |
| **2.** | | | |
| **3.** | | | |
| **…** *shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | |

Buxheti mesatar i parashikuar për promovim në vit dhe mesatarisht në muaj

### Kapaciteti i shitjeve

*Bazuar në sa më sipër, llogarisni vëllimin e shitjes dhe vlerën = qarkullim për muajt e vitit të parë. Kujdesuni që të konsideroni: a) mund të ketë ndryshime sezonale të kërkesës (p.sh.*

*turizmi, produktet rurale); (b) Asnjëherë mos besoni që ju mund të filloni me kapacitet të plotë që nga fillimi. Lini të rritet ne mënyrë realistike;(c) Ndoshta ju filloni të shisni produkte të caktuara vetëm në vitin 2 ose 3; (d) Sigurohuni që tabela të jetë në harmoni me tabelat dhe planifikimet e bëra më sipër.*

| **Prodhimi/Sherbimet dhe kapaciteti i shitjeve** | **Sa produkte ose sherbime mund të gjeneroni dhe shisni në muaj në një kapacitet të plotë?** | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Produkt/Sherbime** | **Njësia** | **Sasia** | **Cmimi i shitjes për njësi** | **Cmimi i shitjes në muaj** |
| 1. | | | | 0 |
| 2. | | | | 0 |
| 3. | | | | 0 |
| 4. | | | | 0 |
| … shto më shumë rreshta nëse nevojitet | | | | 0 |

Parashikoni shitjet për 12 muaj.

| **Prodhim/Shërbim dhe Shitjet Njësitë reale në muaj** | ***Sa produkte ose shërbime mund të gjeneroni dhe shisni në muaj në një kapacitet të plotë?*** | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Muaji**<br>**Produkt/Shërbim** | **1 Njësi** | **2 Njësi** | **3 Njësi** | **4 Njësi** | **5 Njësi** | **6 Njësi** | **7 Njësi** | **8 Njësi** | **9 Njësi** | **10 Njësi** | **11 Njësi** | **12 Njësi** | **TOTALI /LEK** |
| 1. | | | | | | | | | | | | | |
| 2. | | | | | | | | | | | | | |
| 3. | | | | | | | | | | | | | |
| 4. | | | | | | | | | | | | | |
| 5. | | | | | | | | | | | | | |
| **… shto më shumë rreshta nëse nevojitet** | | | | | | | | | | | | | |
| **TOTAL LEK** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

Parashikoni shitjet për 3 vite.

| **Viti**<br>**Produkt/Shërbim** | **1 Lek** | **2 Lek** | **3 Lek** |
|---|---|---|---|
| 1. | | | |
| 2. | | | |
| 3. | | | |
| 4. | | | |
| 5. | | | |
| ***… shto më shumë rreshta nëse nevojitet*** | | | |
| **TOTAL** | **0** | **0** | **0** |

## Performanca e aktivitetit ndër vite

*(Plotësoni tabelën e mëposhtme mbi treguesit kryesorë financiarë në 3 (tre) vitet në vijim.)*

**Në rast se aplikanti është një biznes që ka më pak se 2(dy) vite i themeluar, atëherë tabela do të plotësohet për të dhënat financiare të viteve në treg dhe parashikimeve për vitet në vijim*
***Në rast se aplikanti është një biznes i ri dhe nuk ka të dhëna financiare për vitet e fundit, atëherë tabela nuk do të plotësohet.*

| **Të Ardhura** | | **Viti 1** | **Viti 2** | **Viti 3** |
|---|---|---|---|---|
| Të Ardhura nga Produktet/shërbimet | | 0 | 0 | 0 |
| Të Ardhura të Tjera (grante) | | | | |
| **A. Totali i të Ardhurave** | | **0** | **0** | **0** |
| **Shpenzimet** | | | | |
| Inpute direkte, lendë të para, etj | | | | |
| Kosto Direkte e Punës | | | | |
| Riparime & Mirëmbajtje | | | | |
| Kosto Indirekte | | | | |
| Qira Zyre/Ndërmarrje | | | | |
| Marketing, Reklama | | | | |
| Materiale të zyrës | | | | |
| Shpenzime sigurimi | | | | |
| Transport | | | | |
| Telekomunikacion, internet | | | | |
| Shpenzime Kontabiliteti | | | | |
| Shpenzime Udhëtimi | | | | |
| Sigurime shëndetësore e shoqërore | | | | |
| Komisione bankare | | | | |
| Interesa të Kredive | | | | |
| Amortizimi i pajisjeve | | | | |
| Kosto të tjera | | | | |
| ***… shto më shumë rreshta nëse nevojitet*** | | | | |
| **B. Totali i Shpenzimeve** | | **#REF!** | **0** | **0** |
| C. Fitimi para taksave (=A-B) | | **#REF!** | **0** | **0** |
| D. Taksa (15%) | 15% | #REF! | 0 | 0 |
| **Fitimi Neto (=C-D)** | | #REF! | 0 | 0 |
| Rikthimi në shitje në % | | #REF! | | |

## Burimet e financimit

Bashkëfinancimi apo kontributi i vetë biznesit duhet të jetë minimumi në vlerën 20% të vlerës totale të propozimit dhe mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare, por mund të shprehet me kontribut në natyrë (in-kind), që mund të jenë paga, vlerë qeraje ambienti (për bizneset ekzistuese), vlerë pajisjesh ekzistuese, etj.

| **Investimi** | | | **Burimi i financimit** | |
|---|---|---|---|---|
| **INVESTIMET FIKSE** | **Shpenzimet** | | **EKUITETE** | |
| 1. Toka | | | Fondet e veta | |
| 2. Ndërtesa (blerë) | | | Kesh në dorë | |
| 3. Makineri & Pajisje | | | Të tjera | |
| 4. Pajisje Zyre | | | **Totali i Ekuiteteve** | **0** |
| 5. Mjete Transporti | | | | |
| 6. Të Tjera | | | | |
| **Totali i Investimeve Fikse** | **0** | | **GRANTE, DONACIONE** | |
| | | | 1. | |
| **INVESTIMI PARA-OPERATIV (IPO)** | | | 2. | |
| | | | **Total grante** | **0** |
| 1. Licensa & Regjistrimet | | | | |
| 2. Trajnim për Aftësim e Menaxhim | | | | |
| | | | **BORXHI – KREDITË** | |
| 5. Të Tjera | | | Miqtë, Kreditim nga familja | |
| **Totali i Investimit Para - Operativ** | **0** | | Kredi Banke Nr 1 | |
| | | | Kredi banke Nr 2 | |
| **KAPITALI QARKULLUES** | | | Financime të tjera | |
| 1. Kostot operacionale të fillimit deri në balancimin e keshit fillestar | | | Të tjera | |
| 2. Furnizimi i parë i materialeve të konsumueshme të zyrës | | | **Totali i Detyrimit të Borxhit** | **0** |
| 3. Furnizimi i parë i materialeve të prodhimit | | | | |
| 4. Rezervë sigurie për likuiditetet | | | | |
| **Totali i Kapitalit Qarkullues** | | | | |
| | | | | |
| **TOTALI I INVESTIMIT** | **0** | | **TOTALI I FINANCIMIT** | **0** |

***Totali i Financimit duhet të jetë më i madh se Totali i Investimit!!!***

## Përmbledhëse e financimit

| Nr. | Përshkrimi i financimit | TOTALI NË LEK |
|---|---|---|
| 1 | Financim nga Granti | |
| 2 | Kontributi i vetë Biznesit | |
| 3 | Burime të tjera financiare | |
| | **TOTALI I BURIMEVE TË FINANCIMIT NË LEK** | |

## Fluksi i parave

| Muajt | 0 (fillim) | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | viti 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A. Keshi hyrës mujor (=E e muajit të mëparshëm) | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | #REF! | #REF! | #REF! | #REF! | #REF! | 0 |
| TË HYRAT | | | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga shitjet e produkteve/shërbimeve | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kreditim, kreditë, donacione | 0 | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Të hyra të tjera | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| B. Totali i të Hyrave | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| DALJET | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Investimi para fillimit (muaji 0) | 0 | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Pajisje shtesë, makineri (jo amortizimi) | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Inpute direkte, lëndë të para, etj. | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto e punës, direkte dhe jodirekte | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Riparime & mirëmbajtje | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Qira zyre, fabrike | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Marketing, a\reklama | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Materiale zyre | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sigurim | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Transport | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Telekomunikacion, internet | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime kontabiliteti | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime transporti | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sigurime shëndetësore & | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| shoqërore | | | | | | | | | | | | | | |
| Komisione bankare | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Interesa të kredive | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Ripagim i kredive | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Dividendë dhe Tërheqje të aksionerëve | | | | | | | | | | | | | | **0** |
| Taksat | | | | | | | | #REF! | | | | | | **#REF!** |
| … shto më shumë rreshta nëse nevojitet | | | | | | | | | | | | | | **0** |
| C. **Totali i Daljeve** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **#REF!** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **#REF!** |
| D. Balanca mujore e Cash flow Neto (= B-C) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | #REF! | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | #REF! |
| E. **Balanca e Keshit Akumulativ** (=A+D) | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **#REF!** | **#REF!** | **#REF!** | **#REF!** | **#REF!** | **#REF!** | **#REF!** |

## Plani i veprimit

Lutem bëni një plan të thjeshtë se si do t'i parashikoni veprimet në të ardhmen.

| PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT | ORGANIZIMI | PERIUDHA | PËRGJEGJËSI |
|---|---|---|---|
| Regjistrimi i Biznesit në QKB | | | |
| Marrja e Licensës (nesë kërkohet) | | | |
| Blerja e pajisjeve | | | |
| Blerja apo marrja me qera për ndërtesën | | | |
| Rekrutimi i personelit | | | |
| Kontratat me personelin | | | |
| Nënshkrimi i kontratave me furnitorët | | | |
| Nënshkrimi i kontratave me blerësit | | | |
| Të tjera | | | |

**Buxheti:**

| Nr. | Lloji i investimit | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi | Total (Lekë) | Financimi i projektit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Bashkia | | Aplikanti | | Totali | |
| | | | | | | Vlerë | % | Vlerë | % | Vlerë | % |
| **1** | **Paga dhe sigurime** | | | | | | | | | | |
| 1.1 | *... shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| 1.2 | | | | | | | | | | | 100 |
| **2** | **Qira** | | | | | | | | | | |
| 2.1 | *... shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| 2.2 | | | | | | | | | | | 100 |
| **3** | **Blerje makineri dhe pajisje** | | | | | | | | | | |
| 3.1 | *... shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| 3.2 | | | | | | | | | | | 100 |
| 3.3 | | | | | | | | | | | 100 |
| 4 | **Dukshmëria** | | | | | | | | | | |
| 4.1 | *... shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| | **Totali (Lekë)** | | | | | | | | | | **100** |

Aneksi 8– Proces verbal i mbylljes së Thirrjes së hapur publike

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Nr.______ Prot                                    Shkodër, më _____._____.202_

**PROCES VERBAL**

**I mbylljes së thirrjes së skemë së grantit**

I mbajtur sot me datë __.__202_, në Bashkinë Shkodër në mbyllje të procesit të dorëzimit të aplikimeve për thirrjen dedikuar individëve të moshës mbi 18 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese inovative.

Thirrja publike është shpallur me datë __.__.202_ në:

- website të Bashkisë Shkodër www.bashkiashkodër.gov.al

Janë të pranishëm nënpunësi i zyrës së protokoll arkives z/znj. ___________ dhe z/znj. _______________ koordinuesi thirrjes së skemës së grantit për vitin 202___.

Bazuar në Udhëzuesin e Aplikimit të miratuar me VKB nr. ...., datë ...../.../.202_, aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen personalisht pranë zyrës me një ndalesë, të vendosura në një zarf që i referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës.

Afati për dorëzimin e aplikimeve është __.__.202__në ora __:__.

Sa më sipër grupi i punës mbylli procesin e dorëzimit të aplikimeve me datë __.__.202__, në ora __:__. Numri rëndor i aplikimeve të dorëzuara në Bashkinë Shkodër deri me datë __.__.202__është _____ (......) aplikime.

Zyra e protokoll arkivës do të administrojë dhe do të ruajë dokumentacionin deri në momentin e mbledhjes së Komisionit të Vlerësimit.

**Koordinues**                                    **Sektori i Protokoll-Arkivit**

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit:

Aneksi **9 – Njoftim për Aplikantët**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**Njoftim për Aplikantët**

Nr. ----------- Prot                                                                 Datë …../...../202….

**Subjekti:** Njoftim mbi rezultatin e aplikimit – Skemë Granti për Bizneset Inovative

Drejtuar ............................

I nderuar Z./Znj. .................,

Në vijim të procesit të vlerësimit të aplikimeve të paraqitura në kuadër të thirrjes publike **"Skemë Granti për të Rinjtë"**, të shpallur nga Bashkia Shkodër, ju njoftojmë se aplikimi / plani i biznesit i paraqitur nga ana juaj është shpallur fitues[13].

Përpara nënshkrimit të kontratës, lutemi të paraqiteni për fazën e rishikimit të planit të biznesit, brenda datës ___________ *(nëse kjo vlerësohet e nevojshme)*.

Ju urojmë suksese në realizimin e idesë suaj për biznesin. Në vijim, do të kontaktoheni me **Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit**, pranë Bashkisë Shkodër, për më shumë informacion mbi procedurat ligjore që pasojnë këtë përzgjedhje, si dhe kushtet dhe afatet për nënshkrimin e kontratës për dhënien e grantit.

…………………

Në vijim të procesit të vlerësimit të aplikimeve të paraqitura në kuadër të thirrjes publike **"Skemë Granti për të Rinjtë"**, të shpallur nga Bashkia Shkodër[14], ju informojmë se aplikimi i dorëzuar nga ana juaj nuk ka arritur pragun minimal të pikëve të kërkuara për përfitimin e grantit dhe, për rrjedhojë, nuk është përzgjedhur.

Në përputhje me **Udhëzuesin për Aplikim,** Aneksi ___, për përfitimin e grantit merren në konsideratë vetëm aplikimet që vlerësohen me më shumë se 65 (gjashtëdhjetë e pesë) pikë.

Ju falënderojmë për interesimin dhe pjesëmarrjen tuaj dhe ju inkurajojmë të aplikoni në thirrje dhe iniciativa të tjera të Bashkisë Shkodër në të ardhmen.

...............................

[13] Për aplikantët e pranuar.
[14] Për aplikantët që nuk janë pranuar.

Në vijim të procesit të vlerësimit të aplikimeve të paraqitura në kuadër të thirrjes publike **“Skemë Granti për të Rinjtë”**, të shpallur nga Bashkia Shkodër, ju informojmë se aplikimi / plani i biznesit i paraqitur nga ana juaj është vlerësuar me ___ pikë, duke përmbushur pragun minimal të pikëve të kërkuara prej 65 pikësh, por nuk është shpallur fitues në këtë fazë të procesit.

Aplikimi juaj është renditur në **listën e pritjes**, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në **Udhëzuesin për Aplikim**, dhe mund të konsiderohet për përfitimin e grantit në rast se krijohen mundësi të reja financimi ose nëse ndodh tërheqja e ndonjë aplikimi të shpallur fitues.

Në rast se do të ketë zhvillime të mëtejshme lidhur me statusin e aplikimit tuaj, do të njoftoheni zyrtarisht nga Bashkia Shkodër.

Ju falënderojmë për interesimin dhe pjesëmarrjen tuaj dhe ju mirëpresim në të tjera iniciativa.

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**Aneksi 10 – Kontrata për dhënien e grantit**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**Nr._______ Prot.** **Datë ___ /___/202…**

**K O NT R A T Ë PËR DHËNIE GRANTI**

*Në kuadër të thirrjes së hapur:”Skemë granti për biznese inovative”*

*Titulli i aplikimit*

*………………………………………………*

Sot, më datë___/___/2026, në Shkodër lidhet kjo kontratë shërbimi ndërmjet:

**BASHKISË SHKODËR** me adresë Rr.‘’13 Dhjetori’’, Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga Z. ____________, në cilësinë e Kryetarit të Institucionit, në vijim referuar edhe si **“Institucioni Financues”,**

Dhe

**PERSONIT FIZIK**, Z/Znj. ____________,j, me NUIS ____________, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. ____________,, me adresë ____________, në cilësinë e Përfituesit të Skemës së Granti për Bizneset Inovative, të shpallur nga Bashkia Shkodër, në vijim referuar si **Përfituesi**,

Institucioni Financues dhe Përfituesi do të referohen në vijim edhe si “Pala” ose “Palët”.

**Neni 1**
**Baza Ligjore**

a. Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994 me ndryshimet përkatëse, neni 463, pjesa V-të, ”Kontratat” titulli I-rë (kreu I-rë deri tek kreu III-të), titulli II-të;
b. Ligji 139/2015 ”Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 25;
c. Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar;
d. Vendim nr. ______ prot., datë …../…/.202__ i Komisionit të Ndihmës Shtetërore;
e. VKB nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028, të Bashkisë Shkodër;
f. VKB nr……., datë …../…/.202__ për "Për miratimin e udhëzuesit të aplikimit për zbatimin e skemës së granteve;

g. Miratimin e shpalljes së thirrjes publike për skemën e granteve për bizneset inovative nr. ……. prot., datë …./…../202__;
**h.** Urdhërit nr. ……. Prot., datë …../01/202__ Për miratimin e udhëzuesit për zbatimin e projekteve të shpallura fituese në thirrjen publike ''Skemë granti për bizneset inovative''.

**Neni 2**
**Përkufizime**

Termat e përdorura në këtë kontratë, kanë kuptimin e mëposhtëm:

2.1 **Kontratë,** nënkupton marrëveshjen e shkruar, e lidhur midis Institucionit Financues dhe Përfituesit.
2.2 **Palë (ët),** nënkupton Institucionin Financues dhe Përfituesin vec e vec, ose të referuar së bashku në këtë kontratë.
2.3 **Institucioni Financues** është Bashkia Shkodër, e cila ka përgjegjësinë për financimin, menaxhimin dhe zbatimin e Skemës së Grantit për Bizneset Inovative.
2.4 **Përfituesi,** nënkupton personin fizik që do të zbatojë projektin në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë.
2.5 **Projekt** do të thotë projekt i përzgjedhur në kuadër të Skemës së Grantit për Bizneset Inovative;
2.6 **Thirrje për Aplikime** do të thotë ftesa publike nga Institucioni Financues, drejtuar një kategorie të identifikuar qartë të aplikantëve, për të propozuar Projekte brenda kuadrit të Skemë Granti për Bizneset Inovative.
2.7 **Buxheti,** nënkupton vlerën monetare që i atribuohen zhvillimit të veprimtarisë ekonomike, të përfshirë në projekt.
**2.8 Plani i aktivitetit,** nënkupton shtrirjen e aktiviteteve të projektit në një periudhë të caktuar kohore.
**2.9 Udhëzuesi për zbatimin e projekteve,** nënkupton udhëzimet për menaxhimin administrativ dhe financiar të projektit.
**2.10 Grupi i Monitorimit**, përfshin nëpunës të Bashkisë Shkodër që janë të angazhuar në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së zbatimit të projektit.
**2.11 Raport monitorimi,** nënkupton analizimin e informacionit dhe mbikëqyrjen e realizimit të projektit.
**2.12 Raport përfundimtar -** nënkupton përmbledhjen e dinamikës (veprimtarive dhe financave) të realizimit të projektit nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundimin e aktivitetit.

**Neni 3**
**Qëllimi i kontratës**

3.1 Qëllimi i kësaj Kontrate është që të miratojë (**transferimin)** grantin e Institucionit Financues për financimin dhe zbatimin e projektit me titull: ……….. (tani e më tutje

“Projekti”), siç përshkruhet në Aneksin 1 “Plani i Biznesit”, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

3.2 Përfituesi fiton grantin sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë dhe anekset bashkëlidhur që janë pjesë e pandarë e saj, të cilat Përfituesi me anë të kësaj deklaron që ka shqyrtuar dhe pranuar.

3.3 Përfituesi pranon grantin dhe merr përsipër të jetë përgjegjës për realizimin e Projektit. Nëse Përfituesi përdor grantin për qëllime të tjera dhe jo për biznesin e aprovuar ose nëse ndërpret aktivitetin e biznesit pa ndonjë arsye objektive, Institucioni Financues do të ndërpresë menjëherë financimin.

**Neni 4**
**Financimi i projektit**

4.1 Institucioni Financues merr përsipër të financojë ………% të kostos totale të lejueshme të Projektit, me shumën maksimale prej…… LEKË.

4.2 Përfituesi do të financojë ……. % të kostos totale të lejueshme të veprimit, me një shumë prej ……… LEKË.

4.3 Kostot totale të lejueshme parashikohen në Aneksin 1 “Plani i biznesit” bashkëlidhur kësaj Kontrate, ku janë lehtësisht të identifikueshme se cilat financohen nga Institucioni Financues dhe cilat bashkë-financohen nga Përfituesi. Në rast se Përfituesi dështon në të gjitha fazat e zbatimit të projektit, për të përmbushur plotësisht ose pjesërisht detyrimin që rrjedh nga neni 6, Institucioni Financues rezervon të drejtën e tij për të ndërprerë këtë Kontratë në përputhje me nenin 18 të kësaj Kontrate.

**Neni 5**
**Periudha e zbatimit të projektit**

Kontrata i shtrin efektet e saj ……… muaj nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët. Ajo mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, me dakordësinë e pasqyruar me shkrim nga palët, duke përcaktuar një datë të re përfundimi. Në asnjë rast, shtyrja e periudhës së zbatimit nuk mund të jetë më vonë së 31 dhjetor 2025.

**Neni 6**
**Të drejtat dhe përgjegjësitë Përfituesit**

6.1 Përfituesi ka të drejtë të marrë pagesën e fondeve deri në shumën e përcaktuar në nenin 4 dhe nenit 9 të kësaj Kontrate dhe deri në shumën për blerje paisje/mallrat/shërbimet e përmendur në Planin e biznesit dhe planin financiar, në përputhje me mënyrën, kushtet dhe afatet kohore të përcaktuara në këtë Kontratë.

6.2 Siguron zbatimin e projektit sipas Udhëzuesit për zbatimin e projektit, në kuadër të thirrjes ‘Skemë granti për biznese inovative’;

6.3 Është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që i vendosen nga kjo Kontratë;

6.4 Harton dhe dorëzon raportet mbi dinamikën (veprimtaritë / financat) e zbatimit të projektit duke shfrytëzuar formatin e raportimit që gjenden në Udhëzuesin për zbatimin e projektit;

6.5 Përfituesi do të sigurojë, përpilojë dhe vë në dispozicion në çdo kohë Institucionit Financues, Bashkisë Shkodër çdo regjistrim ose informacion, me gojë ose me shkrim, që Bashkia mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve.

6.6 Informon Bashkinë për çdo vështirësi të identifikuar gjatë zbatimit të projektit.

6.7 Përfituesi bie dakord të bëjë të gjitha rregullimet e duhura, kur Grupi i Monitorimit evidenton çështje të caktuara, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe në përputhje me legjislacionin e shqiptar përkatës;

6.8 Përfituesi ka përgjegjësi të plotë financiare për të siguruar zbatimin e Projektit në përputhje me këtë Kontratë;

6.9 Përfituesi dorëzon kërkesat për pagesë, shoqëruar me dokumentet e nevojshme për verifikimin e kostove dhe shpenzimeve të projektit.

6.10 Përfituesi merr përsipër të sigurojë të gjitha licencat, lejet, dokumentet e kategorizimit, certifikatat e regjistrimit të nevojshme, etj. në lidhje me performancën e aktivitetit, të përcaktuar në planin e tij/saj të biznesit.

6.11 Përfituesi nuk do të ndryshojë formën ligjore të biznesit të tij dhe nuk do të rregullojë dhe as nuk do të pengojë ndonjë pronë, e cila u mor me anë të fondeve të grantit ose që përdoret për zbatimin e planit të biznesit, pa marrë leje me shkrim nga Institucioni Financues.

**Neni 7**
**Të drejtat dhe përgjegjësitë e Institucionit Financues:**

7.1 Institucioni financues ka të drejtë të kryejë kontroll në vend në çdo kohë dhe në fazën e zbatimit të investimit dhe për aq kohë sa kjo kontratë është në fuqi.

7.2 I komunikon Përfituesit, përmes nëpunësit Grupit të Monitorimit në lidhje me çdo çështje që mund të paraqitet gjatë zbatimin e Kontratës;

7.3 Bën pagesat sipas dispozitave të nenit 9 të kësaj Kontrate;

7.4 Njofton Përfituesin në lidhje me çdo delegim ose ndryshim të Grupit të Monitorimit, sipas nevojës;

7.5 Institucioni financues mund të refuzojë transferimin e grantit, nëse Përfituesi nuk përmbush detyrimet kontraktore të përcaktuara.

7.6 Përfaqësuesit e autorizuar të Institucionit Financues munden që në çdo moment të kryejnë vizita në terren për sa i përket:

i. progresit të aktiviteteve sipas planit të biznesit;
ii. vëzhgimit të aktiviteteve dhe shpenzimeve të programit;
iii. organizimit të biznesit;
iv. verifikimit objektiv të shpenzimeve;
v. ndikimit nga përdorimi i grantit.

**7.7** Ata gjithashtu, mund të kërkojnë dokumente që mbështesin kostot dhe dokumente të tjera, raporte verbale dhe me shkrim, shpjegime, etj.

**7.8** Siguron dhe vendos në dispozicion të Subjektit fituesin informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e zbatimit të projektit.

**Neni 8**
**Kostot e lejueshme**

8.1 Kritere për lejueshmërinë e kostove:

Kostot e pranueshme janë kostot e bëra nga Përfituesi që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a. ato janë bërë gjatë zbatimit të Projektit;

b. tregohen në Planin e biznesit dhe Planin financiar të përllogaritur për Projektin siç parashikohet ne Aneksin 1 të kësaj kontrate;

c. janë të nevojshme për zbatimin e projektit;

d. janë të identifikueshme dhe të verifikueshme sidomos të regjistruara në regjistrin e llogarive të Përfituesit dhe të përcaktuara sipas standardeve të mbajtjes së llogarive dhe praktikave të zakonshme të llogaritjes së kostos që zbatohen për Përfituesin;

e. përputhen me kërkesat e legjislacionit shqiptar;

**f.** janë të arsyeshme, të justifikuara dhe përputhen me kërkesat e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sidomos në lidhje me ekonominë dhe eficencën.

8.2 Kostot në lidhje me blerjet dhe shërbimet duhet të jenë në linjë me aktivitetet e kryera gjatë periudhës së zbatimit.

8.3 Kostot në lidhje me furnizimet lidhen me dorëzimin dhe instalimin e sendeve gjatë periudhës së zbatimit. Nënshkrimi i një kontrate, bërja e një porosie, ose marrja përsipër e një angazhimi për shpenzime brenda periudhës së zbatimit për ofrimin e ardhshëm të shërbimeve, si dhe kryerja e punimeve ose furnizimeve pas mbarimit të periudhës së zbatimit, nuk do konsiderohen në përputhje me këtë përcaktim.

8.4 Kostot e kryera duhet të paguhen përpara paraqitjes së raportit përfundimtar. Ndërsa në raportet e ndërmjetme, ato mund të paguhen më pas nëse renditen në raportin

përfundimtar së bashku me datën e përllogaritur të pagesës.

**Neni 9**
**Kushtet për transferimin e grantit**

9.1 Kontrata lidhet për vlerën __________lekë me tvsh.

9.2 Financimi realizohet nga Buxheti 202__ i Bashkisë Shkodër.
Vlera financiare e kontratës duhet të depozitohet në llogarinë bankare të Përfituesit, sipas vertetimit origjinal bashkëlidhur kësaj kontrate.

9.3 Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Shkodër do të kryejë likuidimin e vlerës totale të projektit, sipas planit të aktiviteteve të përcaktuar në projekt, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshje nga fondi i parashikuar në buxhetin e vitit 202_ të Bashkisë Shkodër.

9.4 Levrimi i shumës do të bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit mbështetës dhe verifikimit të tij nga Bashkia Shkodër për paga, blerje, sherbime, dukshmëri, sipas Udhëzuesit për zbatimin e projekteve për përiudhën kohore nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje deri në përfundim të saj.

9.5 Fondi i miratuar për këtë qellim është në zbatim të Thirrjes publike ‘’Skemë Granti për Bizneset Inovative’’.

9.6 Përfituesi do ta përdorë grantin tërësisht brenda kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

9.7 Përdorimi i plotë i grantit do të verifikohet në një Raport mbi Përdorimin e Fondeve i nënshkruar nga përfaqësuesi i Institucionit Financues. Dorëzimi dhe aprovimi i raportit do të krijojë kushtet për revokimin e kërkesave të përcaktuara në udhëzues.

**Neni 9**
**Ndalimi i Nënkontraktimit**

Përfituesi për zbatimin e projektit për të cilën është shpallur fitues nuk i lejohet të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë.

**Neni 10**
**Prona Intelektuale**

10.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Përfituesi gjatë kontratës do ti përkasin atij, i cili mund ti përdorë ato sipas gjykimit të tij.

10.2 Përfituesi duhet të sigurojë Institucionin Financues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e shërbimeve

sipas kësaj kontrate.

**Neni 11**
**Përgjegjësia për pronën**

11.1 Institucioni Financues, në asnjë rrethanë ose për asnjë arsye cilado qoftë ajo nuk mund të jetë përgjegjës për dëm ose dëmtim të pësuar nga stafi ose ndaj pronës së Përfituesit gjatë zbatimit të Projektit ose si pasojë e Projektit. Prandaj, Institucioni financiar nuk mund të pranojë kërkesa për kompensim ose rritje në pagesë në lidhje me këtë dëm ose dëmtim.

11.2 Përfituesi mban i vetëm përgjegjësi ndaj palëve të treta, për çdo dëm të pësuar prej tij gjatë zbatimit të Projektit ose si pasojë e Projektit. Përfituesi e çliron Institucionin financiar nga çdo përgjegjësi që lind nga ndonjë pretendim ose padi e ngritur si pasojë e shkeljes së rregullave ose rregulloreve nga Përfituesi ose punonjësi apo individë të Përfituesit për të cilët ata punonjës janë përgjegjës.

**11.3** Institucioni Financues, në asnjë rrethanë nuk është përgjegjës për dëmet që mund të shkaktohen nga faktorët natyrorë.

**Neni 12**
**Lejet dhe licensat**

Përfituesi do të jetë përgjegjës sigurimin e lejeve dhe licensave sipas kërkesave të legjislacionit Shqiptar për kryerjen e sherbimeve në këtë kontratë, përvec rasteve kur palët bien dakord ndryshe.

**Neni 13**
**Vendndodhja**

Aktivitetet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë Shkodër, siç janë përcaktuar në projekt.

**Neni 14**
**Dukshmëria**

Palët njohin rëndësinë e dhënies dukshmëri bashkëpunimit të tyre në kuadrin e kësaj kontrate dhe për këtë arsye bien dakord të njohin rolin dhe kontributin e secilës palë në proces. Palët bien dakord të përdorin logon e Bashkisë Shkodër, në përputhje me rregullat e këtij institucioni.

**Neni 15**

**Njoftimet e Palëve**

15.1 Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

15.2 Njoftimet duhet të përmbajnë, por nuk kufizohen, tek të dhënat si më poshtë:

**a.** detajet e duhura në lidhje me shkakun e mospërmbushjes dhe të zgjidhjes;

**b.** afatin për korrigjimin e ngjarjes së mospërmbushjes si dhe veprimet/masat, që pasojnë mosrespektimin e afatit, sipas përcaktimeve në këtë kontratë;

**c.** çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

15.3 Adresat dhe numrat e kontaktit, që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, janë:

Për Institucionin Financues
Z./Znj ______________
Adresa: Rr. "13 Dhjetori", nr. 1, Shkodër,
E – mail: _____________

Për Përfituesin:
Z./Znj ____________
Adresa:
Tel: ____________ E-mail: ___________

**Neni 16**
**Mosmarrëveshjet**

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpiqen t`i zgjidhin me mirëkuptim. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ato i drejtohen zgjidhjes së kontratës duke respektuar procedurat juridike sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 17**
**Rishikimi i Kontratës**

Palët ruajnë të drejtën e rishikimit të Kontratës, në rastet kur Institucioni Financues e vlerëson të nevojshme të kryhen ndryshime thelbësore në këtë Kontratë.

**Neni 18**
**Ndërprerja e Kontratës**

18.1 Institucioni Financues mund të ndërpresë këtë Kontratë pa ndonjë dëmshpërblim ndaj perfituesit, kur:

a. Përfituesi pa arsye, nuk përmbush detyrimin thelbësor të vendosur ndaj tij nga kjo

Kontratë dhe, pasi njoftohet me shkresë për përmbushjen e këtyre detyrimeve, akoma nuk e bën këtë ose nuk jep një shpjegim të pranueshëm brenda 30 ditëve nga marrja e shkresës;

b. Përfituesi ka ndryshuar situatën ligjore, financiare, teknike, organizative ose të pronësisë të Përfituesit duke ndikuar në zbatimin e kësaj kontrate ose vënë në pikëpyetje zbatimin efektiv të projektit;

c. Përfituesi është gjetur fajtor për një shkelje në lidhje me sjelljen e tyre profesionale të provuar me çdo mjet, apo vendim gjyqësor.

18.2 Nëse ndodh ndonjë shkelje, Institucioni Financues mund t'i japë fund kontratës duke dërguar një njoftimin me shkrim 7 ditë para, si rrjedhojë Përfituesi do të jetë përgjegjës për rimbursimin e shumës së plotë të fondeve të grantit të marra brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i kontratës.

**Neni 19**
**Dispozita të fundit**

19.1 Për çështje që nuk parashikohen në këtë kontratë, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit civil dhe tregtar shqiptar.

19.2 Palët deklarojnë vullnetin e tyre për mirëbesim dhe konfidencialitet në marrëdhëniet e tyre.

19.3 Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate është:

- Aneksi 1: Plani i Biznesit
- Certifikatë regjistrimi

19.4 Kjo kontratë u hartua në 3 kopje nga të cilat njërën e merr Përfituesi ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

| | |
|---|---|
| **PËR INSTITUCIONIN FINANCUES**<br>**BASHKIA SHKODËR**<br>**Kryetar** | **PËR PËRFITUESIN** |
| **Benet Beci** | ____________ |

**ANEKSI 1:  FORMULAR PËR PLAN BIZNESI**

# FORMULAR PLAN BIZNESI

**(Do të shtohet plani i biznesit i dorëzuar nga aplikuesi, pas fazës së rishikimit)**

**Buxheti**

| Nr. | Lloji i investimit | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi | Total (Lekë) | Financimi i projektit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Bashkia | | Aplikanti | | Totali | |
| | | | | | | Vlerë | % | Vlerë | % | Vlerë | % |
| **1** | **Paga dhe sigurime** | | | | | | | | | | |
| 1.1 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| 1.2 | | | | | | | | | | | 100 |
| **2** | **Qira ambjenti** | | | | | | | | | | |
| 2.1 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| 2.2 | | | | | | | | | | | 100 |
| **3** | **Blerje makineri dhe pajisje** | | | | | | | | | | |
| 3.1 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| 3.2 | | | | | | | | | | | 100 |
| 3.3 | | | | | | | | | | | 100 |
| 4 | **Dukshmëria** | | | | | | | | | | |
| 4.1 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | 100 |
| | **Totali (Lekë)** | | | | | | | | | | **100** |

**Aneksi 11 – Raporti Narrativ, raporti financiar dhe situacioni**

**Raporti Narrativ (për subjektet)**

**Emri i subjektit:**

| Periudha e raportimit | NGA (data) | DERI MË (datën) |
|---|---|---|
| | | |

| | |
|---|---|
| Emri i Përfituesit: | |
| Adresa: | |
| Telefon: | |
| Email: | |
| Iban: | |

Identifikimi i projektit:

| | |
|---|---|
| Emri i projektit: | |
| Vendndodhja: | |
| Fillimi i projektit: | |
| Përfundimi i projektit: | |

**Buxheti dhe financat**

| | |
|---|---|
| Buxheti total (i miratuar) | |
| Fondet e transferuara deri më tani: | |
| Kontributi i aplikantit: | |

| |
|---|
| *Ju lutem përshkruani veprimtaritë dhe rezultatet e projektit.* |
| *Përshkruani deri në cfarë mase është realizuar plani i veprimit të zbatuar gjatë periudhës së raportimit. Si ka shkuar ecuria e nxjerrjes së lejeve, licencave, etj dhe dokumente të tjera në lidhje me performancën e aktiviteteve të biznesit?* |

| |
|---|
| *Ju lutem përshkruani vështirësitë/problemet e hasura gjatë zbatimit të projektit si dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.*<br>*a) Cilat ishin arsyet?*<br>*b) A është informuar Institucioni Financiar për ndryshimet?c) Si do të ndikojnë këto ndryshime ne rezultatet dhe qëllimin e projektit?* |
| *Përshkruani veprimtaritë nga plani juaj i veprimit që do të zbatohen në periudhën e ardhshme.* |
| *Informacion tjetër që mund të ketë lidhje me projektin ( Nëse ka)* |
| *Ju lutem shtoni fotografi në raport. Ju lutem shtoni të paktën 6 fotografi të projektit të realizuar.* |

Vendi dhe data e raportimit

Emër/ Mbiemër
Nënshkrimi

**Raporti financiar dhe situacioni**

**Raporti mbi Përdorimin e Përkohshëm/Përfundimtar të Grantit për aplikantin**

.....................................................................................................................

| **Aktivitetet** | | **Shpenzimet në LEK** | |
|---|---|---|---|
| **E planifikuara** | **Reale** | **E planifikuara** | **Reale** |
| 1. Qiraja, | | | |
| | | | |
| | | | |
| 2. Makineritë, pajisjet, software gjithsej | | | |
| | | | |
| | | | |
| 3. Rezervat fillestare të furnizimeve dhe lëndëve të para gjithsej | | | |
| | | | |
| | | | |
| 4. Pagat dhe rrogat gjithsej | | | |
| | | | |
| | | | |
| 5. Promovimi dhe reklamimi i aktiviteteve gjithsej | | | |
| | | | |
| | | | |
| ***TOTALI*** | | | |

U përgatit nga: ................................. U rishikua nga:………………………
(Përfaqësuesi i Biznesit) (Grupi i monitorimit i Bashkisë Shkodër)

U konfirmua nga: ................................
( Nëpunësi autorizues)

## Situacion financiar

| Nr. | Lloji i investimit | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi | Total (Lekë) | Financimi i projektit | | | | | | Realizimi Situacion 1 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Bashkia | | Aplikanti | | Totali | | Bashkia | Aplikanti | Balanca |
| | | | | | | Vlerë | % | Vlerë | % | Vlerë | % | Progresiv situacion 1 | | |
| **1** | **Paga dhe sigurime** | | | | | | | | | | | | | |
| 1.1 | | | | | | | | | | | | | | |
| 1.2 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | | | | |
| **2** | **Qira ambienti** | | | | | | | | | | | | | |
| 2.1 | | | | | | | | | | | | | | |
| 2.1 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | **Blerje makineri dhe pajisje** | | | | | | | | | | | | | |
| 3.1 | | | | | | | | | | | | | | |
| 3.2 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | | | | |
| **4** | **Dukshmëria** | | | | | | | | | | | | | |
| 4.1 | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.2 | *… shto më shumë rreshta nëse nevojitet* | | | | | | | | | | | | | |
| | **Totali (Lekë)** | | | | | | | | | | | | | |

**Aneksi 12– Formulari i Monitorimit**

**Raporti Periodik/Përfundimtar**

| **Periudha e raportimit** | NGA (data) | DERI MË (datën) |
|---|---|---|
| | | |

| | |
|---|---|
| Emri i organizatës: | |
| Adresa: | |
| Telefon: | |
| Email: | |
| Personi përgjegjës për aplikuesin | |

**<u>Identifikimi i projektit:</u>**

| | |
|---|---|
| Emri i projektit: | |
| Vendndodhja: | |
| Fillimi i projektit: | |
| Përfundimi i projektit: | |

**<u>Buxheti dhe financat</u>**

| | |
|---|---|
| Buxheti total (i miratuar) | |
| Fondet e transferuara deri më tani: | |
| Kontributi i aplikantit: | |

| **Pyetjet e monitorimit për bizneset që aktualisht po përdorin grantin, por që nuk kanë filluar operimin e biznesit** | | | |
|---|---|---|---|
| A po zhvillohen aktivitetet sipas programit? Ju lutemi përshkruani ndonjë ndryshim të paautorizuar që u bë gjatë vizitës për monitorimin: | Po | Jo | Pjesërisht |
| Koment: | | | |
| A janë mjediset e biznesit në dispozicion dhe gati për përdorim? Ju lutemi përshkruani gjendjen e mjediseve, lejet përkatëse, etj.: | Po | Jo | Pjesërisht |
| Koment: | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| A i ka biznesi të gjitha lejet, licencat, patentat, certifikatat, politikat e sigurimeve përkatëse dhe dokumente të tjera në lidhje me performancën e aktiviteteve të biznesit, siç specifikohen në planin e biznesit? | Po | Jo | Pjesërisht |
| Koment: | | | |
| A ka blerë përfituesi i grantit pajisjet e specifikuara në planin e tij/saj të biznesit? Ju lutemi përshkruani gjendjen e pajisjeve: | Po | Jo | Pjesërisht |
| Koment: | | | |
| A ka blerë përfituesi i grantit furnizimet dhe lëndët e para të specifikuara në planin e biznesit? | Po | Jo | Pjesërisht |
| Koment: | | | |
| A e filloi biznesi veprimtarinë brenda datës së planifikuar fillestare? Nëse jo, cilat janë disa prej shkaqeve të vonesës, a ka ndonjë kërkesë për shtyrje dhe cila është periudha e shtyrë për nisjen efektive të biznesit? | Po | Jo | Pjesërisht |

| **Pyetjet e monitorimit për bizneset që përdorën grantin dhe filluan operimet e biznesit** |
|---|
| Si e promovon përfituesi i grantit biznesin e tij/saj? A ka biznesi materiale promocionale ose një faqe interneti; a merr pjesë në panaire, ekspozita për tregun, evente biznesi, etj.? |
| Si i shet biznesi produktet/shërbimet e tij? A ka kontrata me klientët? Ju lutemi ofroni detaje. |
| Si është situata e stafit në biznes– sa punonjës punojnë në biznes, cilat janë aftësitë e tyre, a ka largim të stafit, a janë krijuar vende pune të reja? |

PËRFUNDIMI: ***Deri më sot, biznesi po arrin/po arrin pjesërisht/nuk po arrin synimet e veta.***

REKOMANDIME:

Data: .___/___/202___

Përfaqësuesi i Biznesit: Grupi i Monitorimit:

**Aneksi 13: DEKLARATA E PAANSHMËRISË DHE KONFIDENCIALITETIT**

**DEKLARATA E PAANSHMËRISË DHE KONFIDENCIALITETIT**

Unë, i nënshkruari **_____________________** (emri dhe mbiemri), anëtar i Komisionit të Vlerësimit për aplikimet per ide biznesi të marra në dorëzim sipas Thirrjes Publike të Bashkisë Shkodër në Konkursin e Ideve Inovative jap si më poshtë:

DEKLARATË NË LIDHJE ME:

**(A) KONFLIKTIN E INTERESAVE**

se nuk jam përfshirë në përgatitjen e ndonjë projekt-propozimi që po shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit, dhe se projektet në fjalë nuk kanë lidhje me:

- Interesat e mia personale (financiare ose të tjera);
- Interesat (personale, financiare ose të tjera) të ndonjë organizate që unë menaxhoj, në të cilën unë punoj, që unë përfaqësoj ose këshilloj.

**(B) KONFIDENCIALITETIN**

I gjithë informacioni i përftuar gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimeve si anëtar i Komisionit të Vlerësimit do të trajtohet rreptësisht në konfidencialitet.

Data: ____/____, 202__

Në Bashkinë Shkodër

Nënshkrimi: _____________________

**Aneksi 14: Formular marrje në dorëzim**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIASHKODËR**

Nr._____ Prot Shkodër, më ____.____.202__

**Aneksi 13. FORMULAR PËR KONFIRMIMIN E MARRJES NË DORËZIM TË DOKUMENTACIONIT PRANË BASHKISË SHKODËR**

Marrje në dorëzim të dokumentacionit të projekt propozimit në Përputhje me Thirrjen Publike në Konkursin e Ideve Inovative e dorëzuar nga __________________________________________________________më - ____/____/202__.

Marrë në dorëzim nga punonjësi i Bashkisë ______________________________________

**Aneksi 15: Kërkesë për likuidim**

**Emri i biznesit**

Nr._____ Prot                                                    Shkodër, më ____.____.2026

Lënda: Kërkesë për Likuidim

Drejtuar: Bashkisë Shkodër

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacion për likuidimin e aktiviteteve të parashikuara në projektin (*titulli i projektit*) sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Subjekti fitues

---------------------------

**Aneksi 16. Deklarata për plotësimin e kritereve**

Emri i biznesit që po zbaton Projektin

**DEKLARATA PËR PLOTËSIMIN E KRITEREVE**

Unë, i nënshkruari/e nënshkruara
(Emri, mbiemri dhe adresa e aplikuesit)

Përfaqësues i /përfaqësuese e
(Emri dhe adresa e aplikuesit)

Konfirmoj se jam përfaqësuesi ligjshëm i aplikuesit dhe se unë, i/e sipërshënuar:

**a)** nuk jemi në gjendje falimentimi;
**b)** nuk kemi ndonjë pagesë të bllokuar me vendim gjyqësor, që çon në humbje të plotë ose të pjesshme të së drejtës sonë për të menaxhuar dhe përdorur pronën tonë;
**c)** nuk jemi objekt i ndonjë procedimi ligjor kundër nesh, përfshirë i urdhrave për pezullim të pagesave që mund çojnë në falimentim dhe që mund të shkaktojnë humbje të plotë ose të pjesshme të së drejtës sonë për të menaxhuar dhe përdorur pronën tonë;
**d)** nuk kemi marrë asnjë vendim fajësie për ndonjë shkelje ose kundërvajtje që lidhet me sjelljen në punë;
**e)** nuk kemi lënë pa përmbushur ndonjë detyrim lidhur me pagimin e sigurimeve shoqërore apo taksave;
**f)** nuk jemi fajtorë për raste të rënda të dhënies së informacionit të rremë për veprimtaritë tona profesionale;
**g)** nuk jemi shpallur fajtorë për shkelje të ndonjë detyrimi kontraktual.
**h)** Jam objekt i deklaratës ndihma De minimis, në zbatimit të ligjit 93473, datë 21.04.2005 ‘për ndihmën shtetërore.

DEKLARATA E BËRË:

(vendi, data) (emri dhe mbiemri, nënshkrimi)

NË PRANI TË:
(vendi, data) (emri dhe mbiemri, nënshkrimi)

**Aneksi 17 – Deklarata De Minimis**

## Deklarata De Minimis[15]

Unë, i nënshkruari __________________, përfaqësues ligjor i subjektit _____________, NUIS _________________, deklaroj se subjekti që përfaqësoj **[nuk ka / ka] përfituar ndihmë de minimis** gjatë tre viteve të fundit fiskale.

Në rast përfitimi, ndihma është marrë nga *(Institucioni)* __________________, në vitin ____________________, në vlerën ________________________.

Deklaroj se shuma totale e Ndihmës De Minimis të përfituar nuk tejkalon kufirin maksimal të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë ligjore në rast deklarimi të pavërtetë.

Subjekti fitues

________________

[15] Neni 8, ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005
Ndihma De Minimis
1. Mbështetja financiare e akorduar në kuadër të kësaj skeme përbën ndihmë shtetërore të kategorisë de minimis, në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005, "Për ndihmën shtetërore", si dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Shuma totale e ndihmës de minimis të përfituar nga një përfitues nuk duhet të tejkalojë kufirin maksimal të parashikuar nga legjislacioni në fuqi brenda një periudhe prej tre (3) viteve fiskale.
3. Përfituesi është i detyruar të paraqesë, përpara nënshkrimit të kontratës dhe disbursimit të fondeve, deklaratën për ndihmën de minimis, ku pasqyrohen të gjitha ndihmat e përfituara gjatë tre viteve të fundit fiskale.
Në rast se konstatohet se përfituesi ka dhënë informacion të pasaktë ose të pavërtetë në deklaratën de minimis, institucioni zbatues ka të drejtë të revokojë mbështetjen financiare dhe të kërkojë kthimin e fondeve të përfituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Aneksi 18. Lista e kontrollit**

**Faza e 1: Dorëzimi i aplikimit të ideve të biznesit;**

1. Formulari i aplikimit për ide biznesi sipas modelit të kërkuar;
2. Kopja e kartës së identitetit të Aplikantit;
3. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), për bizneset ekzistuese;
4. Vertetim xhiro për 3 vitet e kaluara nga e-albania për bizneset ekzistuese;
5. Vërtetim për saktësim adrese.

**Faza e 2: Dorëzimi i planit të biznesit（për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.)**

1. Plani i Biznesit dhe Financimit sipas modelit të kërkuar;
2. Dorëzimi i pasqyrave financiare (bilanci) për dy vitet e fundit të aktivitetit të biznesit;
3. Çertifikime/patenta, apo dokumente të tjerë suportues të cilët vërtetojnë elementin inovativ përbëjnë prioritet;
4. Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëse aplikanti nuk ka detyrime financiare ndaj këtij institucioni (për aplikantët të cilët kanë biznes ekzistues);
5. Dëshmi penaliteti e aplikuesit, lëshuar gjatë muajit të hapjes së thirrjes;